




REALIZIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË INSTITUCIONET PARTNERE TË PROJEKTIT “AFTËSI PËR PUNË”

VLERËSIM VJETOR

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



swisscontact

REALIZIMI I PRAKTIKAVE PROFESIONALE NË INSTITUCIONET PARTNERE TË PROJEKTIT “AFTËSI PËR PUNË” – VLERËSIM VJETOR

Qershor 2021

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Raporti u përgatit nga Nertila Busho.

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J

Rruga Skënderbej, Vila nr. 49

Tiranë, Shqipëri, Kutia Postare 2891

Tel: +355 42 231 850

e-mail: al.info@swisscontact.org

www.aftesiperpune.al

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	4
II.	Hyrje.....	7
III.	Metodologjia.....	8
IV.	Përputhshmëria e zhvillimit të praktikave profesionale me skemën e sugjeruar nga projekti S4J 9	
IV.1	Zbatimi i skemës së praktikave profesionale në fazat parapërgatitore	9
IV.2	Zbatimi i skemës së praktikave pas sistemimit të nxënësve në biznese.	13
IV.3	Kërkesa në rritje e bizneseve për tu bërë pjesë e bashkpunimit me shkollat dhe rritja e punësimit të nxënësve	15
V.	Perceptimet e mësuesve dhe nxënësve mbi praktikat profesionale.....	16
V.1	Perceptimet e mësuesve mbi praktikën profesionale	16
V. 1.1	Ndër aktorët më të informuar mbi skemën e praktikave profesionale të sugjeruar	18
V. 2	Perceptimet e nxënësve mbi praktikën profesionale	19
V.2.1	Perceptimi i nxënësve për instruktorët e praktikave dhe instruktorët e bizneseve	22
V.2.2	Nxënësit që kanë zhvilluar praktikën në ambientet e shkollës	23
V.3	Fotografim i thjeshtëzuar i shkollave mbi zbatimin e skemës së sugjeruar të praktikave profesionale.	25
VI.	Konstatimet e studimit cilësor në vijim të rezultateve të studimit sasior	28
VII.	Përfitimet e konsideruara nga mësuesit dhe nxënësit në lidhje me praktikat profesionale	31
VIII.	Sfidat e këtij procesi që evidentohen nga aktorët.....	34
IX.	Adresimet përkatëse, mbështetur në diskutime mbi sfidat e konstatuara.....	37

Shkurtime

AKPA - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

S4J - Skills for Jobs – Projekti “Aftësi për Punë”

TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

SHTET- Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë

I. Përmbledhje ekzekutive

Në mbi 80% të aktorëve që kanë marrë pjesë në diskutimet e realizuara gjatë këtij studimi mendojnë se praktikat profesionale afatgjata në biznes janë një mundësi shumë e mirë që nxënësit të ekspozohen në tregun e punës. Falë aftësive profesionale, njohurive të reja dhe aftësive të buta që nxënësit përfitojnë gjatë këtij procesi, atyre u mundësohet një punësim i menjëhershëm. Në këto kushte, rëndësia e këtij studimi rrjedh nga rëndësia që ka vetë praktika profesionale dhe fokusi i tij është vendosur në shumë dimensione të këtij procesi.

Qëllimi dhe objektivat

Eksplorimi mbi zhvillimin e procesit të praktikave profesionale në 9 shkollat partnere të projektit S4J është vetë qëllimi i këtij studimi, i cili synohet të përmbushet nëpërmjet analizimit, interpretimit dhe validimit të informacionit të marrë nga aktorët e përfshirë në skemë (drejtuesit, mësuesit, nxënësit). Objektivat e studimit parashtrohen si më poshtë:

1. Të evidentojë mënyrën e zbatimit të skemës së praktikës nga ana e shkollave partnere si dhe shkallën e përputhshmërisë së saj me skemën e sugjeruar nga S4J.
2. Të shqyrtojë perceptimet dhe dinamikën e aktorëve të praktikave profesionale në biznes, duke nxjerrë në pah qëndrimet, problematikat, përfitimet dhe nevojat, të para në një këndvështrim kronologjik.
3. Të nxjerrë në pah ngjyrimet brenda aktorëve të të njëjtit grup, si dhe mes drejtimeve/profileve të shkollave.
4. Të validojë dhe krahasojë rezultatet me vitin e mëparshëm dhe studimin sasiar.
5. Të adresojë sfidat e ndeshura nga aktorët dhe të ofrojë rekomandime të vlefshme.

Metodologjia dhe të dhënat

Për këtë studim janë përdorur kryesisht të dhëna cilësore, të cilat janë mbledhur nëpërmjet intervistave të thelluara dhe diskutimeve në fokus grupe. Studimi bazohet në triangulimin mes të dhënave cilësore, atyre sasiore, si dhe punës me studime dhe raporte të mëparshme, ku pjesa më e madhe e informacionit është mbledhur nga vizitat në shkolla dhe vetëm disa diskutime plotësuese u kryen nëpërmjet telefonatave. Numri total i aktorëve të përfshirë në këtë kërkim është 171, nga të cilët 24 janë drejtuesit e shkollave dhe mësuesit si edhe 147 nxënës. Fokus grupet dhe intervistat e thelluara kanë përfshirë nxënës të vitit të X, XI, XII dhe XIII të të gjitha drejtimeve të përfshira në shkollat pjesëmarrëse.

Gjetjet kryesore

Skema e praktikës në biznes në këtë vit, të influencuar nga kufizimet e pandemise COVID-19, ka një përputhje të kënaqshme me skemën e sugjeruar nga projekti S4J në diskutimet mbi njohjen e procesit nga aktorët, por në zbatimin praktik ajo është aplikuar me ndryshime të vogla duke u përshtatur sipas shkollave me situatën e krijuar.

- Orientimi dhe këshillimi në karrierë është realizuar, por kufizimi i orarit nuk i ka mundësuar një kohë të mjaftueshme për ta ndjekur atë me detaje.
- CV-të dhe letrat e motivimit në më të shumtin e rasteve janë ndërtuar si një punë projekti dhe nuk janë përdorur për seleksionimin e nxënësve nga bizneset.
- Kryesisht nxënësit janë përcaktuar në bizneset përkatëse mbështetur në gjykimin e instruktorëve të praktikës dhe mësuesve kujdestarë.

-
- Në skemën e zbatuar nga shkolla vijon të ketë mangësi në: mospërputhjen e planit të punës me atë që nxënësit realizojnë në praktikë; përpilimin e planeve të punës me bizneset; rotacionin e posteve të punës; monitorimin e praktikave nga instruktorët e praktikës.

Koordinatorët e marrëdhënieve me biznesin janë aktorët që i konsiderojnë praktikën në biznes si pjesë e identitetit të shkollës. Ata janë ndër më të informuarit për gjithë procesin e praktikave në biznes dhe mbajnë edhe ngarkesat procedurale që lindin gjatë këtij procesi. Gjatë diskutimeve me ta janë evidentuar edhe disa shqetësime të cilat lindin nga pamundësia për të zbatuar në praktikë disa rregulla dhe kërkesa të përcaktuara nga autoritetet vendimarrëse. Ndërsa edhe pse shkollat shfaqin dëshirë për të bashkëpunuar me bizneset, në disa prej tyre shfaqet një rezistencë e lehtë nga instruktorët e praktikave profesionale për të vijuar praktikën me nxënësit në biznese duke e bazuar arsyetimin në: moshën e nxënësve; pamundësinë për ti dërguar të gjithë nxënësit në biznese; kohën e kufizuar për t'i ndjekur dhe monitoruar nxënësit në të gjitha bizneset si edhe dëshirën për të ndarë me ta eksperiencën dhe njohuritë personale. Sipas shkollave, vidojmë të kemi ende bashkëpunim me biznese neglizhente sa i përket zhvillimit të praktikës dhe kjo duhet të shërbejë si nxitës tashmë për të filluar seleksionimin e tyre.

Nxënësit shprehin se praktika në biznes është shumë e rëndësishme për ta duke i mundësuar: konkretizimin në praktikë të asaj që merret në teori; vendosjen në kushte reale pune; mundësinë për të përdorur mjete, metoda pune apo programe më të avancuara; rritjen e shansit të punësimit në biznes etj.. Sipas eksperiencës së tyre ndër arsye kryesore të avancimit të nxënësve në profesionin e zgjedhur dhe më pas të punësimit janë: dëshira e nxënësit për tu përfshirë në profesion; gadishmëria dhe përkushtimi në reagim gjatë procesit të praktikës; komunikimi i nxënësve si edhe paraqitja e tyre. Gjithashtu janë vënë re edhe eksperiencia jo të kënaqshme në praktikën pranë bizneseve, por këto janë në numër shumë të vogël. Përgjithësisht nxënësit shprehin të kënaqur me kushtet e shkollës si edhe trajtimin e mësuesve por shohin të nevojshme shpeshimin e vizitave të mësuesve pranë bizneseve.

- **Përfitimet e nxënësve nga praktika profesionale** (*evidentuar nga nxënësit*) përcaktohen me: Përballja e hershme me tregun e punës dhe njohja e tij; Njohja e mjeteve, instrumentave, programeve dhe teknikave që përdoren në kushte reale pune; Punësimi i nxënësve me kohë të pjesshme dhe të plotë gjatë viteve të shkollës; Përfitimi i një shpërblimi monetar; Përmirësimi i aftësive të buta dhe elementëve bazë të profesionit; Konkretizimi i njohurive teorike të marra në shkollë.
- **Përfitimet e shkollës/instruktorëve në shkollë nga praktika** (*evidentuar nga drejtuesit dhe mësuesit*) kanë të bëjnë me: përmirësimin e imazhit të shkollave dhe promovimi i tyre; punësimin e nxënësve në biznese nëpërmjet ndërmjetësimit të shkollës; pozicionimit të shkollave më pranë tregut të punës; nxitjen e instruktorëve në shkolla për rritjen e tyre profesionale; ndryshimi i opinionit mbi vlerën e arsimit të mesëm profesional në tërësi.

Sfidat kryesore të parashtruara

- Përshtatja sa më e mirë e kurrikulave me kërkesat dhe nevojat e tregut.
- Ndërtimi i planeve dhe strategjive afatgjata në nivel kombëtar për shkollat profesionale.

-
- Zbatimi i të gjitha specifikave të vendosura në rregulloren e re të AKPA-s (p.sh kriteret e bizneseve që përfshihen në skemën e praktikave profesionale si edhe shpërndarja e orëve të praktikave profesionale në biznese dhe shkollë).
 - Plotësimi me materiale të nevojshme, për lëndët profesionale, i profileve të reja që hapen në shkollat profesionale.
 - Angazhimi i instruktorëve në ndjekjen e njëkohëshme të nxënësve që realizojnë praktikat në biznes dhe atyre që i zhvillojnë në shkollë.
 - Shpërndarja e nxënësve në biznese me distanca të largëta gjeografike dhe monitorimi i tyre.
 - Ngarkesa e instruktorëve në biznes me mbulimin e detyrave të pozicionit në biznes dhe njëkohësisht realizimin e rolit të instruktorit për nxënësit.
 - Ndërgjegjësimi i bizneseve mbi rolin që luajnë në zinxhirin e shkollimit profesional.
 - Ekzistenca e bizneseve të specializuara/të fokusuara, të cilat nuk mundësojnë zhvillimin e të gjitha moduleve të praktikës pranë tyre.
 - Praktikrat e punësimit të nxënësve nga bizneset.
 - Përballja me perceptimin/gjykimin mbi cilësinë e kontigjentit të nxënësve.
 - Rritja e numrit të nxënësve praktikantë në drejtime që kanë kufizime nga ofertat e tregut.
 - Plani i nxënësve për tu larguar jashtë vendit.

Rekomandime

- Ndërtimi i strategjisë afatgjatë të shkollave profesionale.
- Rishikimi i disa çështjeve të rregullores së publikuar nga AKPA.
- Kërkesa e plotësimit për dokumentacione të nevojshme të adresohet nëpërmjet drejtuesve të shkollave.
- Ndërgjegjësimi i instruktorëve të praktikave profesionale, për rolin e rëndësishëm që kanë.
- Ndërtimi i mekanizmave favorizuese për bizneset që përfshihen në skemën e praktikave profesionale.
- Informim dhe ndërgjegjësim i nxënësve mbi këshillimin dhe orientimin në karrierë.
- Të ndërtohen materialet e profileve të reja përpara se të nisin regjistrimet për drejtimin.
- Përzgjedhje e kujdesshme e bizneseve partnere nga shkollat.
- Organizim i tryezave të diskutimit ndërmjet bizneseve.
- Një intensifikim i punës së stafit të shkollës
- Përshtatja e drejtimt me tregun e punës nëpërmjet azhornimit të mjeteve, materialeve dhe metodologjive më të fundit.

II. Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë mbi zhvillimin e procesit të praktikave profesionale në 9 shkollat partnere të projektit S4J. Ky qëllim është synuar të përmbushet nëpërmjet analizimit, interpretimit dhe validimit të informacionit të marrë nga aktorët e përfshirë në skemë si drejtuesit, mësuesit dhe vetë nxënësit. Objektivat e studimit parashtrohen si më poshtë:

1. Të evidentojë mënyrën e zbatimit të skemës së praktikës nga ana e shkollave partnere si dhe shkallën e përputhshmërisë së saj me skemën e sugjeruar nga S4J.
2. Të shqyrtojë perceptimet dhe dinamikën e aktorëve të praktikave profesionale në biznes, duke nxjerrë në pah qëndrimet, problematikat, përfitimet dhe nevojat, të para në një këndvështrim kronologjik.
3. Të nxjerrë në pah ngjyrimet brenda aktorëve të të njëjtit grup, si dhe mes drejtimeve/profileve të shkollave.
4. Të validojë dhe krahasojë rezultatet me vitin e mëparshëm dhe studimin sasior.
5. Të adresojë sfidat e ndeshura nga aktorët dhe të ofrojë rekomandime të vlefshme.

Shkollat e përfshira në studim, si edhe një vit më parë janë: “Hamdi Bushati” - Shkodër, “Kolin Gjoka” - Lezhë, “Tregtare” - Vlorë, “SHIP” - Vlorë, “Gjergj Canco” – Tiranë, “Kristo Isak” – Berat, “SHTET” - Tiranë, “Ali Myftiu” – Elbasan dhe “Salih Ceka” – Elbasan. Studimi në terren, është kryer gjatë periudhës 3 maj - 16 qershor, ku në të gjitha shkollat janë konsideruar një sërë indikatorësh që lidhen me procesin e praktikave profesionale në të cilën përfshihen drejtuesit, mësuesit e shkollave dhe nxënësit. Studimi ka në fokus realizimin e një vlerësimi sa më të plotë të situatës aktuale në shkollat partnere duke trajtuar çështjet që lidhen me dinamikën e një sërë proceseve si: regjistrimi dhe përgatitja e nxënësve për fillimin e praktikave, sistemimi i nxënësve në biznese, monitorimi dhe vlerësimi i nxënësve gjatë periudhës së praktikës, problematikat që hasen në zbatim të skemës së praktikës, perceptimet e mësuesve dhe nxënësve mbi këto procese, përfitimet që shkollat, mësuesit dhe nxënësit kanë në gjithë këtë skemë të aplikuar, aftësitë e fituara nga nxënësit përgjatë këtij procesi dhe përkthimin e tyre në nevojat e tregut të punës.

Në përmbyllje të studimit, synohet që duke konsideruar sfidat e evidentuara gjatë diskutimeve me mësuesit dhe nxënësit e shkollave të adresohen propozime që mund të shtojnë vlerë në konsiderimin e tyre mbi vijueshmërinë e procesit në të ardhmen.

III. Metodologjia

Për zhvillimin e këtij studimi dhe për të përmbushur qëllimin e të qënurit sa më pranë realitetit është përdorur triangulimi mes të dhënave cilësore, të dhënave sasiore të mbledhura paraprakisht, si edhe punime të mëparëshme mbi këtë çështje sa i përket raporteve dhe studimeve të mëparëshme. Të dhënat primare janë bazuar në qasjen cilësore dhe janë mbledhur nëpërmjet dy metodave:

- 1- Intervistave të thelluara (koordinatorët e marrdhënieve me biznesin, instruktorët në shkollë, mësues¹, drejtuesit e shkollave si edhe me nxënësit që shfaqnin vështirësi për tu shprehur gjatë diskutimeve në grup).
- 2- Fokus grupe dhe diskutime (realizuar me nxënësit e profileve të ndryshme nga klasat e X, XI, XII dhe XIII në të gjitha shkollat)

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të përmbledhur numri i aktorëve të përfshirë në studim.

Tabela 1: Numri i aktorëve të përfshirë në studim²

	Aktorët e përfshirë në studim		
	Nxënës	Drejtues/Mësues	Total
Aktorët	147	24	171

Kampionimi i nxënësve u realizua mbështetur në natyrën e profileve, peshën e profilit sa i përket numrit të nxënësve të profilit me totalin e numrit të nxënësve në shkollat respektive si edhe numrin e nxënësve që kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë bizneseve. Një vëmendje të veçantë gjatë diskutimeve iu kushtua gjuhës së trupit të aktorëve, në këtë mënyrë ngjyrimet, reagimet dhe qëndrimet ishin më të lehta për tu deshifruar dhe sjellë në çështjet e ndryshme të raportit. Gjithashtu vlen të theksohet se studimi i referohet një viti akademik të influencuar nga kushtet e kufizuara që pandemia COVID-19 mundësoi. Sa i përket të dhënave sekondare të përdorura ato i referohen shfrytëzimit të hulumtimeve të mëparshme, manualeve, studimit sasior të realizuar për vitin akademik 2020/2021 dhe të dhënave statistikore që projekti S4J disponon mbi shkollat pjesëmarrëse. Ky studim u shtri në 6 rajone në të cilat shkollat janë të vendosura si më poshtë:

- Tiranë, në shkollat “Gjergj Canco” dhe “SHTET”;
- Elbasan, në shkollat “Ali Myftiu” dhe “Salih Ceka”;
- Vlorë, në shkollën “Tregtare” dhe shkollën Industriale “Pavarësia”;
- Berat, në shkollën “Kristo Isak”;
- Shkodër, në shkollën “Hamdi Bushati”;
- Lezhë, në shkollën “Kolin Gjoka”.

¹ Më së shumti janë përfshirë mësuesit e lëndëve profesionale dhe instruktorët e praktikave profesionale.

² Aktorët e përfshirë në studim janë detajuar sipas shkollave në tabelën 2 ne Aneks të raportit.

IV. Përputhshmëria e zhvillimit të praktikave profesionale me skemën e sugjeruar nga projekti S4J

Implementimi i skemës së praktikave profesionale i propozuar nga projekti S4J, konsideruar edhe ndikimin e pandemisë COVID-19 që përcaktoi një mori kufizimesh në gjithë sistemin arsimor si pezullimin e përkohshëm të mësimin, shkurtimin e orëve mësimore apo edhe zhvillimin e mësimin të alternuar fizik dhe online si edhe ndikimin që pandemia pati në mbylljen e përkohëshme të disa prej bizneseve aktive, evidentohet të këtë qenë për vitin aktual edhe më sfidues dhe të shfaqë përputhje më të pakta pothuajse në çdo fazë krahasuar me një vit më parë. Në mënyrë më të detajuar procesi është konsideruar sa më poshtë për të trajtuar çështje pas çështjeje një krahasim sesi shkollat e kanë implementuar skemën e propozuar nga projekti.

IV.1 Zbatimi i skemës së praktikave profesionale në fazat parapërgatitore

Siç shpjegohet kryesisht nga drejtuesit e shkollave profesionale dhe koordinatorët e marrëdhënieve me bizneset, gjithçka nis me fushatat promovuese në shkollat 9-vjeçare, ditën e dyerve të hapura ku shkollat presin vizitorë (përgjithësisht nxënësit potencial) si edhe ndërtimin e video-ve të shkurtra promovuese me ndihmën e projektin, të cilat realizohen nga mbyllja e një viti akademik duke parashtruar në këtë mënyrë disa hapa për vitin akademik që do të nisë. Procesin i regjistrimit të nxënësve në shkollë, thuajse nga të gjitha shkollat, shfrytëzohet edhe si një moment orientues për nxënësin duke i shpjeguar që në këtë proces se si do të zhvillohet praktika profesionale e tij si dhe cili do të jetë fokusi i profilit në të cilin nxënësi po regjistrohet.

Përgjatë diskutimeve me mësuesit vihet re se faza parapërgatitore, që nga *para-orientimi i nxënësve nga regjistrimi dhe ditët e para të fillimit të vitit akademik* është i njohur dhe shkollat janë familjarizuar me të si proces duke pasur edhe strukturat përkatëse për zhvillimin e tij. Në këtë fazë njësia e zhvillimit, stafi për këshillim karriere si edhe mësuesit kujdestar luajnë një rol shumë të rëndësishëm. **Të gjitha shkollat, përgjatë këtij viti, kanë bërë përpjekje për ta zhvilluar sipas skemës së sugjeruar procesin para-orientues edhe pse stafi i ndërgjegjësuar për kushtet në të cilat ky proces është kryer, shprehet se çdo proces gjatë këtij viti ka pasur kufizime në kohë për arsye të orëve të reduktuara, kështu që fokusi është vendosur kryesisht vetëm në çështjet më të rëndësishme. Me të njëjtin konstatim shprehen edhe nxënësit për këtë fazë. Një pjesë e madhe e nxënësve të viteve të X nuk kanë mundur ta konsiderojnë plotësisht si një proces më vete duke u shprehur se nuk kanë informacion që në shkollë ekziston një njësi zhvillimi dhe nuk kanë kuptuar nëse ka ndodhur ndonjë orientim tjetër përveç sugjerimeve paraprake të instruktorëve të praktikës mbi mënyrën sesi duhet të sillen në ambientet e biznesit përgjatë praktikës që do të zhvillojnë.**

Ndërkohë si një proces i cili shtrihet gjatë gjithë vitit është edhe *ndërtimi i marrëdhënieve me bizneset e reja* për të mundësuar kështu rritjen e numrit të bizneseve të mundshme në të cilat nxënësit të zhvillojnë praktikën profesionale. Ky aspekt i influencuar së pari nga situata e pandemisë, por gjithashtu siç shprehen koordinatorët e marrëdhënieve me biznesin, edhe nga ngarkesa e tyre me punë rutinore dhe procedura për plotësimin e dokumentacioneve të nevojshme, e ka bërë më të vështirë këtë proces që të jetë frytëdhënës. Një pjesë e mirë e bizneseve të regjistruara rishtaz për bashkëpunimin me shkollat kanë ardhur si rezultat i kërkesës së vetë bizneseve (kryesisht bizneset bar-restorante dhe hotele). Gjithashtu një ndihmë e madhe për ndërtimin e këtyre marrëdhënieve, falë ndërhyrjeve të projektit S4J, është evidentuar në disa profile specifike si ai i ekonomikut dhe TIK (kryesisht në shkollën SHTET dhe Gjergj Canco).

Të gjitha shkollat kanë konsideruar për të shtuar në listën e tyre të bizneseve partnere të gjithë bizneset që kanë dëshirën për të bashkëpunuar dhe për të plotësuar kushtet më bazike për qëndrimin e nxënësve në ambientet e tyre. Gjendur përballë faktit se jo çdo biznes i mundëson nxënësve zhvillimin e të gjitha moduleve të praktikës **një pjesë e shkollave kanë zgjedhur të jenë pak më tepër fleksibël se skema e propozuar duke zbatuar në këtë mënyrë rotacion biznesesh** (Kryesisht shkolla “Kristo Isak³” në profilin e Hoteleri Turizmit, shkolla “Kolin Gjoka⁴” në profilin e Teknologji Ushqimore si edhe “Gjergj Canco⁵” në drejtimin Elektroteknik). **Sa i përket shkollave që kanë një eksperiencë më të madhe në implementimin e kësaj skeme shprehen se ka ardhur momenti që kriteret përzgjedhëse të biznesit të specifikohen më qartë dhe shkolla të bëjë një përzgjedhje mes bizneseve potenciale** (kjo kryesisht shprehet nga shkolla “Tregtare”, dhe shkolla “Pavarsia”).

Njohja fillestare e nxënësve me disa nga bizneset e mundshme për të aplikuar për zhvillimin e praktikave profesionale në disa shkolla si “Tregtare” dhe “Kolin Gjoka” ka nisur të strukturohet duke krijuar një databazë fillestare të bizneseve bashkëpunuese të cilën e adresojnë edhe tek nxënësit, në disa raste të prezantuar me fletpalosje e në disa raste nëpërmjet prezantimit të historikut të të gjithë bizneseve partnere. Ndërsa shkollat e tjera janë në fillime të krijimit të kësaj databaze, në këto shkolla nxënësve u jepet informacioni për bizneset potenciale nga instruktori i praktikës, koordinatori i marrëdhënieve me biznesin apo edhe mësuesi kujdestar.

Në shkollat që janë përfshirë më hershëm në projekt si “Tregtare”, “Pavarësia”, “Kolin Gjoka”, “Hamdi Bushati” dhe “Kristo Isak” vihet re se aktiviteti i *ndërtimit të një CV-je dhe letre motivimi*, në mënyrë që nxënësit të kryejnë aplikimin për tu pranuar për zhvillimin e praktikës në një biznes, është i konkretizuar dhe kjo vihet në dukje kryesisht nga nxënësit e viteve XI, XII dhe XIII **ndërsa nxënësit e klasës së X mund ta kenë ndjekur ndërtimin e CV-së dhe letrës së motivimit si një detyrë projekti, por nuk i kanë parë ato në të gjitha rastet si një element**

3 Këtë vit të influencuar edhe nga pandemia bëhej për arsye që nxënësit të përthithnin receta nga më të ndryshmet

4 Modulet e këtij profili vështirë të plotësohen në një biznes të vetëm pasi bizneset janë shumë të specializuar në këtë fushë.

5 Kryesisht kjo zgjidhje i referohej bindjes së mësuesit në mënyrë që nxënësit të merrnin sa më shumë informacione.

të rëndësishëm për përzgjedhjen nga biznesi, pasi gjerësisht përcaktimi në biznesin që kanë realizuar praktikën është bërë nga instruktorët e praktikave profesionale. Gjithsesi ky proces është shumë i njohur nga mësuesit e shkollave duke e reflektuar atë si një aktivitet të rëndësishëm që realizohet çdo vit në qëllim të përshtatjes sa më të mirë të nxënësve me biznesin. Ndër shkollat e reja mund të përmendim shkollën “SHTET”, ku pavarësisht rasteve jo të mëdha në numër të nxënësve që kanë mundur të zhvillojnë praktikën në biznes, ata që janë përzgjedhur e kanë realizuar ndërtimin e cv-së dhe letrës së motivimit dhe përcaktojnë se për ta, këto instrumente kanë qenë të nevojshme për aplikimin dhe më pas ndjekjen e procesit të praktikës në këtë biznes.

Si në çdo vit të kaluar, në drejtimet që shfaqen vështirësi në identifikimin e bizneseve të përshtatshme (kryesisht drejtimet industriale por e përqëndruar edhe në shkollat e reja si “Ali Myftiu” dhe “Salih Ceka”), njohjet familjare e miqësore të mësuesve dhe nxënësve me biznese të ndryshme kanë luajtur një rol të konsiderueshëm në ndërtimin e marrëdhënieve me bizneset. Gjithsesi nëse do të konsideronim shkollat në tërësi, u konstatua se **pjesa më e madhe e nxënësve e kanë gjetur vendin e praktikës kryesisht nëpërmjet ndihmës së koordinatorit të marrëdhënieve me biznesin dhe një pjesë tjetër më e vogël me ndihmën e instruktorit të praktikës profesionale apo edhe të mësuesit kujdestar.** Një numër i vogël i nxënësve rezultojnë ta kenë gjetur vendin e praktikës nëpërmjet njohjeve të tyre individuale dhe familjare.

Vlen të theksohet se, këtë vit, **të gjitha shkollat kanë nënshkruar marrëveshjet tripalëshe për të gjithë nxënësit që kanë zhvilluar praktikën në biznese** dhe në disa raste kjo marrëveshje ka ngelur në fuqi për të mundësuar vijimin e kësaj marrëdhënieje edhe gjatë muajve të verës. Ky instrument tashmë është shumë i njohur për të gjitha shkollat dhe gjatë diskutimeve me mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, ata i’a atribuojnë këtë arritje projektit S4J. Kjo marrëveshje tashmë është zyrtarizuar dhe dërguar këtë vit nëpër shkolla edhe nga AKPA, ku siç evidentohet edhe nga diskutimet me shkollën “Kolin Gjoka” të dhënat e nxënësit që plotësohen në këtë marrëveshje, me ndryshimet e këtij viti, nuk janë aq të detajuara sa vitet e mëparshme dhe kjo e bën edhe më praktike përdorimin e saj.

Të evidentuar edhe në vitin e kaluar, dy elemente që shfaqin një shmangie më të madhe nga skema e sugjeruar nga projekti deri në momentin e sistemimit të nxënësve në biznese janë:

- 1. Mospërputhja e plotë e planit të punës me atë që nxënësit realizojnë në praktikë*

Në procesin e përzgjedhjes së bizneseve, mësuesit pohojnë se një ndër kriteret që kanë konsideruar më tepër në këtë vit ka qenë afërsia e vendbanimit të nxënësve me vendodhjen e biznesit gjithashtu ata kanë marrë në konsideratë edhe kritere të tjera si: mundësitë e realizimit të asaj që parashikojnë modulet, numri i nxënësve që mund të presë biznesi për praktikë, kapaciteti fizik i tij, etj. Gjithsesi, pavarësisht njohjes së mirë të kriterëve që bizneset

duhet të përmbushin në parim, ajo që nxënësit zhvillojnë në praktikë jo gjithnjë përputhet me përmbajtjen e moduleve për disa arsye si:

- Kompani të specializuara në profile të caktuara (kryesisht profilet industriale, TIK-u dhe teknologji ushqimore);
- Një numër i limituar i bizneseve lokale, të cilat nuk mbulojnë numrin total të nxënësve apo edhe të gjitha fushat dhe shërbimet që kërkohen sipas moduleve;
- Gjithashtu ka edhe biznese të veçanta me të cilat shkolla ka një eksperiencë shumë pozitive dhe falë kësaj eksperience shkollat bëjnë kompromis për t'i pasur këto biznese pjesë të bashkëpunimit të tyre.

Mënyra sesi shkollat i kanë konsideruar dhe kanë reaguar në përmbushje të këtyre boshllëqeve të konstatuara është e ndryshme në shkolla dhe në profile të ndryshme. Në disa profile boshllëqet e krijuara në përmbushje të të gjitha moduleve pranë biznesit, plotësohen gjatë orëve të praktikës në shkollë, në disa raste të tjera shkollat kanë zgjedhur t'i plotësojnë këto boshllëqe duke i dërguar nxënësit në disa biznese të tjera që ja mundësojnë edhe modulet e munguara si edhe një opsion i tretë që shihet në përmbushje të këtyre boshllëqeve është dërgimi i numrit më të madh të nxënësve në ato biznese që kanë mundësi të zhvillojnë të gjitha modulet e planit mësimor.

2. Mungesa e përpilimit dypalësh të planeve të punës të nxënësve

Në ndryshimet nga vitet e tjera, ku disa nga shkollat kishin nisur përpjekjet e përpilimit të planeve dypalëshe, kryesisht me bizneset që ishin më tepër të përfshirë dhe të gatshëm në bashkëpunim, sivjet vihet re një zbehje e plotë e këtij qëllimi. Pothuajse të gjithë mësuesit shprehin se ky vit ka qenë një vit i vështirë si për shkollat ashtu edhe për bizneset dhe e parë në këtë këndvështrim ata kanë preferuar të mos i rëndojnë bizneset apo edhe instruktorët në biznes edhe me këtë kërkesë të tyre, por e kanë konsideruar të mjaftueshme për këtë vit që bizneset në morinë e problematikave të hasura kanë pranuar sërish të jenë pjesë e skemës së praktikave profesionale dhe të bashkëpunojnë me shkollën. Në disa shkolla plani i hartuar fillimisht nga mësuesi në mbështetje të planit mësimor i janë bërë të ditur edhe instruktorëve të bizneseve (shkolla Tregtare dhe Kolin Gjoka) ndërsa disa shkolla të tjera në më të shumtën e rasteve kanë preferuar që planin e veprimit të mbështetur në planin mësimor ta ndanin vetëm me nxënësin që do të zhvillonte praktikën (shkolla Hamdi Bushati, Pavarësia, Ali Myftiu, Salih Ceka, Kristo Isak).

Gjithsesi shkollat të cilat kanë bashkëpunuar me mentorë të cilët kanë marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar për mentorët shprehin se në vijim nëse situata do të normalizohet dhe mentorët e bizneseve do të jenë pjesë e këtyre trajnimeve do të jetë shumë më e lehtë të përfshien këta mentor në momentin e realizimit të planit të praktikës së nxënësve në biznese.

IV.2 Zbatimi i skemës së praktikave pas sistemimit të nxënësve në biznese

Pas diskutimeve me nxënësit e viteve të X apo edhe nxënës të viteve të tjera, që u caktuan për të parën herë për të zhvilluar praktikën në biznese, u vu re se vetëm një numër i vogël i tyre kaluan procesin e aplikimit dhe përzgjedhjes nga bizneset sipas skemës së propozuar. Kryesisht nxënësit janë pozicionuar në biznese nga sugjerimet e mësuesve duke konsideruar si kriter fillestar afërsinë e biznesit me vendbanimin, rezultatet e nxënësve ku nxënësit që kanë treguar një performancë më të mirë janë pozicionuar në ato biznese që janë konsideruar nga mësuesit si me predispozitë më të madhe për tu dedikuar ndaj nxënësve dhe një pjesë e vogël e nxënësve e kanë gjetur biznesin ku kanë zhvilluar praktikën në mënyrë individuale.

Proceset që vijnë pas pozicionimit të nxënësve nëpër biznese, të cilat janë sugjeruar nga projekti, janë të njohura dhe të aplikueshme nga pjesa më e madhe e instruktorëve të praktikave, ndërsa koordinatorët e marrëdhënieve me biznesin janë ata që i kanë të qarta këto procese në detaje. Në përgjithësi, duke qenë se këto procese kanë veprime konkrete që përmbillen me veprime të matshme vërehet se skema e sugjeruar nga projekti nga ana procedurale është më e lehtë për tu zbatuar (aktivitetet që bëjnë pjesë janë rotacioni në pozicionet e punës brenda një biznesi, mentorimi në biznes, monitorimi i praktikantëve nga instruktorët në shkollë, vlerësimi dypalësh shkollë-biznes i praktikantëve, etj.). Ndërkohë vendosja e këtyre proceseve në praktikë shfaq disa mangësi në:

1. *Rotacionin në postet e punëve* - në jo pak raste, zhvillimi i praktikës pranë një biznesi nuk shoqërohet me rotacion në pozicione të ndryshme pune pasi së pari ekziston mungesa e dëshirës së disa bizneseve për t'i pozicionuar praktikantët në të gjitha sektorët për një sërë arsyesh si: vendosja e nxënësit në atë pozicion/sector që ai tregon më tepër aftësi; vendosja e nxënësit në pozicionin ku biznesi ka më shumë nevojë; mungesë besimi në aftësitë e praktikantëve; për mungesë kohe të instruktorit në biznes; nga frika e humbjeve apo dëmeve; nga frika nga konkurrenca në rast punësimi të nxënësit nga një biznes tjetër; nga frika e marrjes në punë të praktikantit në vend të instruktorit në biznes apo njërit prej anëtarëve të stafit. Gjithashtu një tjetër arsye e cila nuk është plotësisht e lidhur me dëshirën dhe mundësinë e bizneseve është rasti i proceseve sezonale apo që varen nga kërkesat dhe nevojat e klientëve.
2. *Mentorimi* - në disa prej rasteve, kur në biznese janë dërguar më shumë se një nxënës për të zhvilluar praktikën, është evidentuar nga nxënësit një fokusim i mentorit në një nga nxënësit që ka treguar më tepër interes në momentet e para të fillimit të procesit duke lënë kështu më në hije pjesën tjetër të nxënësve. Këto raste janë të rralla dhe janë evidentuar vetëm në profilin hoteleri-turizëm.
3. *Monitorimi i praktikantëve* nga instruktorët e praktikave profesionale. Këtë vit ky proces i monitorimit ka qenë më i zbehtë se vitet e kaluara. Frekuenca e ulët e monitorimit në ambientet e bizneseve, është evidentuar në pjesën më të madhe të

shkollave. Kjo situatë është përcaktuar e tillë nga një sërë arsyesh që kanë ndikuar si: **Së pari, zhvillimi i mësimet me dy grupime**, ka sjellë një ngarkesë për mësuesit e lëndës si edhe detyrimi i prezencës së nxënësve ka qenë i reduktuar në kohë. **Së dyti, largësia e bizneseve nga shkolla apo nga njëri-tjetri**. Për më tepër në një pjesë të shkollave që kanë nxënës nga rrethet u lejua dhe u mundësua që praktikantët profesionale të ndiqeshin sa më pranë vendbanimeve të tyre. Kështu që në këto raste si edhe në ato biznese të cilat kanë një distancë të madhe me shkollën procesi i monitorimit është realizuar kryesisht nëpërmjet modaliteteve alternative (telefonata, mesazhe, e-maile, whatsapp, video calls etj..). Duhet theksuar se këto mënyra alternative të monitorimit kanë dhënë shkas për të filluar bashkëpunime mes nxënësve dhe biznesit për ta kthyer zhvillimin e praktikave në një proces fiktiv. **Së treti, ndarja e nxënësve gjatë orarit të praktikës**, në disa shkolla vijon të ketë klasa tek të cilat një pjesë e grupit e zhvillon praktikën në biznes dhe një pjesë tjetër e zhvillon praktikën në ambientet e shkollës. Në këto rrethana instruktorët e praktikave vendosen përballë sfidës për të udhëhequr praktikantët në klasë dhe për të monitoruar paralelisht nxënësit në biznes. Një pjesë e instruktorëve në shkollë në profilet teknike, duke besuar edhe te roli i instruktorit në biznes, shohin më të arsyeshme qëndrimin pranë nxënësve që e zhvillojnë praktikën në klasë dhe, sipas mundësive, vizitojnë bizneset, si dhe mbajnë kontakte me telefon me instruktorët në biznes. **Së katërti, shpërndarja e praktikantëve në orare të ndryshme dhe ditë të ndryshme të javës**. Në mënyrë që të mos ketë ngarkesa në bizneset lokale të cilat janë të kufizuara në numër, në disa raste është përcaktuar zhvillimi i praktikave në orare dhe ditë të ndryshme. Kështu zhvillimi i praktikës optimizohet duke lehtësuar biznesin dhe nxënësin, por nga ana tjetër e bën më të vështirë monitorimin.

4. *Vlerësimi i nxënësve mbi praktikën në biznes*. Të gjithë aktorët këtë vit konstatohet të jenë në dijeni se vlerësimi i nxënësve është rezultatja e vlerësimit të dhënë nga instruktori në biznes dhe e vlerësimit të instruktorit në shkollë. Vetë nxënësit edhe pse kanë të qartë se në vlerësimin e tyre merret në konsideratë edhe vlerësimi i instruktorit në biznes, jo të gjithë kanë të qartë se në çfarë mase ndikon ky vlerësim për notën e praktikës profesionale. Në disa shkolla, instruktorët e praktikave profesionale duke konsideruar afrimitetin dhe “dashamirësinë” e treguar nga vlerësimi i biznesit e kanë konsideruar atë me rezerva ose duke i dhënë një peshë më të vogël se ajo e propozuara. Ky qëndrim pohohet edhe nga vetë nxënësit, të cilët shprehen se kryesisht me ato biznese që instruktori i praktikës në shkollë nuk ka afrimitet apo njohje personale, vlerësimi pothuajse përcaktohet nga vetë instruktorët në shkollë duke e konsideruar vlerësimin e biznesit si jo objektiv.

IV.3 Kërkesa në rritje e bizneseve për tu bërë pjesë e bashkëpunimit me shkollat dhe rritja e punësimit të nxënësve

Një tjetër proces, që po merr frymë e po formësohet në vijimësi të procesit të praktikave profesionale dhe bashkëpunimit që po ndërtojnë shkollat me bizneset, është edhe punësimi i nxënësve nga bizneset. **Kërkesat e ardhura nga bizneset për punësimin e nxënësve, si nga bizneset me të cilat shkollat kanë pasur marrëdhënie bashkëpunuese por edhe me biznese të reja, janë bërë më të shpeshta.** Në diskutimet me drejtuesit e shkollave dhe koordinatorët e marrëdhënieve me bizneset, disa nga shkollat si “Tregtare”, “Kolin Gjoka”, “Ali Myftiu”, dhe “Salih Ceka” përveç se e kanë përkufizuar këtë si një përmbyllje të suksesshme të të gjithë hapave të praktikës profesionale pranë bizneseve, shprehin mendimin se ky proces duhet strukturuar për vitet në vijim. Hasur me një fluks kërkesash, kryesisht në përmbylljen e vitit akademik që korespondon edhe me sezonin e verës, në shkollën “Hamdi Bushati” është vendosur një tavolinë në njësinë e zhvillimit dhe të gjithë nxënësit kanë plotësuar një formular që lidhet me dëshirën dhe kërkesën e tyre për tu punësuar. Ky formular është vendosur më pas në një dosje sipas profilit të nxënësve. Ndërkohë, mësuesit shqyrtojnë kërkesat e ardhura prej bizneseve, për të bërë një përshtatje sa më të mirë mes këtyre kërkesave dhe interesave të shprehura nga nxënësit nëpërmjet formularëve. Në disa raste mësuesit e përshkruajnë këtë kërkesë dhe lidhjen që po krijohet me tregun e punës, si fillësë e ndërtimit të një qëndre punësimi pranë shkollës, të cilën kanë filluar ta kenë “zili” edhe vetë zyrat e punës të qyteteve përkatëse. Bizneset të cilat janë më të shpeshta me kërkesat e tyre për punësim janë hotelet, bar-restorantet, agjensi turistike, serviset e automjeteve apo edhe biznese që operojnë në industrinë e rëndë.

V. Perceptimet e mësuesve dhe nxënësve mbi praktikat profesionale

Praktikat profesionale në biznes përfaqësojnë një proces kompleks dhe delikat nëse marrim në konsideratë marrëdhëniet mes aktorëve të përfshirë. Duke qenë se roli i koordinatorëve të marrëdhënieve me bizneset dhe instruktorëve në shkollë është thelbësor për organizimin e punës dhe mbarëvajtjen e praktikave në biznes është e nevojshme të konsiderojmë perceptimet mbi eksperiencën e tyre në këtë vit akademik. Në vijim të këtyre perceptimeve janë konsideruar edhe mendimet dhe eksperiencat e përjetuara gjatë këtij viti nga nxënësit që konsiderohen aktori thelbësor i këtij procesi.

V.1 Perceptimet e mësuesve mbi praktikën profesionale

Shkollat shfaqen gjithnjë e më të përgatitura për të bashkëpunuar me bizneset. Normalisht që ky disponibilitet dhe aftësia për tu përshtatur vjen kryesisht nga eksperiencat e mëparshme të fituara në kuadër të praktikave profesionale në biznese; nga trajnimet e kryera në sajë të projektit S4J gjatë aktiviteteve të zhvilluara si edhe forcimit të bindjes së praktikave profesionale përmirësojnë performancën dhe imazhin e shkollimit profesional në tërësi. Gjithsesi vihet re se jo në të gjitha rastet instruktorët e rinj në shkolla janë të informuar sidomos nga ana e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të ndjekë secilin proces. Në disa raste të veçanta, si në shembullin e shkollës “Kolin Gjoka”, instruktorët e rinj përcaktohen nga nxënësit si më të përkushtuar, ndërsa kjo justifikohet me faktin se ata janë në periudhë prove nga mësuesit e tjerë dhe duhet të tregojnë vetën për të vijuar karrierën e tyre edhe në vitet në vazhdim. Krahasimisht me vjet vihet re një rritje e lehtë e numrit të instruktorëve në shkolla, të cilët shprehen paksa skeptikë mbi praktikat që realizohen në biznese, bazuar në:

- a. moshën e re të hyrjes në praktikë (për nxënësit e klasave të X),
- b. mospërputhjen e profilit të ofruar nga shkolla me sektorët që mundësojnë bizneset,
- c. mungesën e seriozitetit të procesit nga mentorët e bizneseve.

Në diskutimet e realizuara me koordinatorët e marrëdhënieve me biznesin dhe instruktorët e praktikave, ata shprehen se bizneset nuk shfaqin ndonjë diferencë të dukshme nga viti i kaluar në drejtim të përgatitjes së tyre për të pritur dhe mentoruar praktikantët. Një diferencë u ndje përkohësisht në ato biznese ku mentorët e të cilëve u përfshinë në trajnimin e mentorëve dhe dëshira për të qenë pjesë e këtyre trajnimeve u shpreh në shkollë në vijimësi edhe nga bizneset e tjera të papërfshira. Sipas mësuesve në shkollë jo në çdo rast cilësia e bizneseve është në nivelin e kërkuar, pavarësisht përpjekjes së shkollës për të qenë sa më selektive, kufizimi i tregut me numrin dhe llojin e bizneseve ka bërë që të përfshihen në skemë edhe biznese jo plotësisht të përshtatshme. Në këtë mënyrë një pjesë e bizneseve sipas instruktorëve të marrëdhënieve me bizneset nuk ofrojnë kushtet për aftësimin e duhur të nxënësve, kushtet e sigurisë teknike në punë, postet e nevojshme që përputhen me kurrikulat

e nxënësve si edhe nuk tregohen të hapur për plotësimin apo dhënien e informacionit të kërkuar mbi biznesin. Në këtë rrjedhë në këto biznese minimizohen edhe mundësitë e instruktorëve në biznes për t'i orientuar dhe trajnuar nxënësit në mënyrën e duhur. Mësuesit në diskutime shprehin se përgatitja dhe roli i instruktorëve në biznes është element thelbësor në masën e aftësisë të nxënësve përgjatë praktikës profesionale në biznes dhe konkretizimi i rolit të instruktorit në biznes shfaq probleme dhe mangësi në disa biznese të cilat lidhen kryesisht me: *mungesën e motivimit të mentorit; mungesë e kohës për realizimin e mentorimit në sajë të ngarkesës së lartë të punës; mungesën e informacionit në lidhje me rolin dhe detyrimet mbi praktikantët si edhe tendenca për të ruajtur informacione sa i përket profesionit që të mos jenë plotësisht të imitueshëm në punën e tyre në të ardhmen.*

Një ndër treguesit më domethënës dhe që deri diku shihet si rezultat i praktikave profesionale në biznese sipas koordinatorëve të marrëdhënive me biznesin dhe instruktorëve në shkollë, është punësimi i nxënësve nga bizneset. Nëse do ta krahasonim këtë tregues me vitin e kaluar mund të themi se pavarësisht situatës dhe vështirësive të vitit shihet se kemi një rritje të ndjeshme të numrit të nxënësve të punësuar gjatë gjithë vitit ose edhe vetëm gjatë periudhës së verës. Numri i bizneseve që kërkojnë staf për të punësuar është rritur në të gjitha shkollat. Ky proces po merr zgjerime të paparashikuara sa që tashmë një pjesë e mësuesve të shkollës sugjerojnë që të konsiderohet si një proces për tu strukturuar në të ardhmen në mënyrë që të kemi një përputhje sa më të mirë të nevojës së bizneseve me nxënësit që sugjerohen tek ta.

Kryesisht shkollat, koordinatorët e marrëdhënive me biznesin dhe instruktorët në shkollë i përcaktojnë praktikat profesionale në biznese shumë të vlefshme për disa aspekte: *plotësimin në aspektin praktik real të kuadrit teorik të njohurive të fituara; përballimin e sfidave me të cilat do të hasen në vendin e punës; përvetësimin e të gjitha proceseve të punës duke e parë atë në tërësi si edhe mundësimin e punësimit nga biznesi, gjatë ose pas përfundimit të praktikës. Kështu sipas tyre, vetëm në sajë të këtyre praktikave në biznes, nxënësit: aftësohen në procese pune të njëjta ose të ngjashme me ato që do të gjejnë në vendin e ardhshëm të punës; përshtaten me tensionin dhe fluksin e punës; mësohen me kulturën e punës; qëndrojnë të përditësuar me të rejat e fushave përkatëse; fitojnë më tepër besim në vetvete dhe bëhen të aftë për të marrë përsipër përgjegjësi; përvetësojnë profesionin dhe hyjnë më shpejt në tregun e punës; si edhe përforcojnë aftësitë e buta.*

Në tërësi mësuesit shprehin se praktikat profesionale në biznes kanë ndikuar në përmirësimin e imazhit të shkollave në veçanti dhe në rritjen e ndërveprimit me bizneset në përgjithësi. Gjithsesi vihet re se jo të gjithë instruktorët në shkollë ndajnë të njëjtin opinion mbi praktikat pranë biznesit dhe aftësimin real të nxënësve në disa profile të veçanta. **Skepticizmi i shfaqur lidhet me efikasitetin e praktikave të realizuara në biznes në drejtimet si Ekonomiku apo edhe TIK-u,** ku instruktorët mendojnë në lidhje me këto profile se bizneset janë tepër të specializuara dhe nxënësit në to përgjithësisht mund të përfitojnë vetëm aftësitë e buta dhe njohuritë më bazike sa i përket rregullave dhe kërkesave të punës. *Mospërputhja e profilit të ofruar nga shkolla në sektorët e bizneseve lokale dhe mungesa e predispozitës së*

bizneseve për ti besuar dhe angazhuar praktikantët në disa procese të caktuara pune janë dy arsye që shoqërojnë profilin ekonomik dhe TIK sipas mësuesve.

Ndër çështjet që nënvizohen nga diskutimet me koordinatorët e marrdhënieve me bizneset është konsiderimi i kërkesave që i adresohen bizneseve të cilat duhet të jenë në mbështetje të njohjes së mjedisit operues dhe të mos kërkohen informacione mbi çështjet delikate që mund të tjetërsojnë edhe marrëdhënien bashkëpunuese. Njëkohësisht në mënyrë që të vijohet me këtë proces të nisur, është e nevojshme të rishihen disa çështje të trajtuara në rregulloren e miratuar nga AKPA, si psh: përfshirja në skemën e praktikave profesionale vetëm e bizneseve që janë të regjistruara, ky përcaktim, në këtë formë përjashton mjaft biznese me të cilat shkollat bashkëpunojnë (kryesisht në drejtimet industriale që lidhen me “ustallarë” ndonëse edhe të paregjistruar). Një tjetër çështje e shprehur nga një pjesë e koordinatorëve, sa lidhet sërish me rregulloren i përket % së orëve të përcaktuara të praktikës profesionale për tu zhvilluar në biznes. Mënyra sesi kjo çështje është parashtruar në rregullore sjell ndryshime nga skema e sugjeruar që është duke u aplikuar momentalisht.

V. 1.1 Ndër aktorët më të informuar mbi skemën e praktikave profesionale të sugjeruar

Eksperienca disavjeçare në lidhje me praktikën në biznes, e shkollave që janë të përfshira më hershëm në bashkpunimin me projektin, si dhe konsolidimi i marrëdhënieve me biznesin, u ka mundësuar një menaxhim më të mirë të skemës në të gjitha hallkat e saj. Ndërsa shkollat që janë përfshirë në bashkëpunim në vitet e fundit (Ali Myftiu, Salih Ceka, SHTET dhe deri diku edhe Gjergj Canco), janë përpjekur të kenë një ritëm më të përshpejtuar për ndjekjen e skemës së propozuar, por në influencimin e kushteve të pandemisë janë mbështetur në eksperiencën e tyre të mëparshme, në eksperiencën e shkollave më të hershme të përfshira në këtë skemë, e kanë konsideruar disa pjesë kyçe të domosdoshme në gjykimin e tyre, për të vijuar me procesin e sugjeruar. Gjatë diskutimeve të realizuara me drejtuesit, instruktorët e praktikave, mësuesit dhe nxënësit e profileve të ndryshme u vu re se në të gjitha shkollat ndër aktorët më të informuar në lidhje me praktikat profesionale janë Instruktorët e praktikës profesionale. Këta aktorë janë në ndjekje të të gjithë procesit dhe në suport të plotë të tij edhe në ato detyra që jo domosdoshmërisht janë të lidhura me pozicionin e tyre. Vlen të theksohet se në ato shkolla që koordinatori i marrdhënieve me biznesin ka qenë i përfshirë që në hapat e para të bashkëpunimit të shkollës me projektin, informacioni që ata kanë mbi skemën e propozuar të projektit dhe evoluimit në kohë është i plotë dhe i detajuar. Vihej re gjithashtu se, në ato shkolla ku koordinatori i marrdhënieve me biznesin ishte i emëruar në dy vitet e fundit, jo çdo detaj dhe informacion mbi skemën e sugjeruar ishte i njohur.

Nga aktorët e ndryshëm vihej re se koordinatorët e marrdhënieve me bizneset përveç se fokusoheshin në kontaktet e vazhdueshme me bizneset egzistuese, vendosjen e

kontakteve me biznest e reja (kjo kryesisht këtë vit është realizuar nga ardhja vetë e bizneseve të reja në shkollë dhe në raste shumë të rralla këto biznese janë evidentuar dhe kontaktuar nga shkolla), vijojnë edhe me procese të tjera si: plotësimi i dokumentacioneve të kërkuara për shkollën nga projekti dhe AKPA; mbajtja e kontakteve të vazhdueshme me instruktorët e praktikave mbi rastet e veçanta të studentëve; kontakte të vazhdueshme me nxënës që zhvillojnë praktikën në biznes, apo edhe me nxënësit e tjerë që zhvillojnë praktikën pranë ambienteve të shkollës për të parë mundësi sitemimi për praktika në biznese; monitorimin e vijueshmërisë së procesit të praktikave pranë bizneseve dhe kontakte me mentorët e nxënësve; është pjesmarrës në aktivitete të tjera që organizon shkolla; jep suport edhe në procese të tjera që ndihmojnë implementimin e skemës së praktikës profesionale në biznese.

Pavarsisht dëshirës së madhe për të qenë pjesë sa më ndihmuese e procesit të zhvillimit të praktikave profesionale në biznese, në diskutimet referuar vitit të fundit shkollor, vihet re një lodhje dhe ngarkesë e koordinatorëve të marrdhënieve me biznesin, ku 3 prej tyre shprehen se në disa momente kanë kërkuar të heqin dorë nga ky pozicion. Disa nga arsyet më të shpeshta të përmendura nga ta si ngarkesë e shtuar nga ajo që ata fillimisht kanë pretenduar renditen si më poshtë:

1. Plotësimi me dokumentacione të shumta që nuk varet plotësisht nga disponueshmëria e tyre.
2. Larmishmëria e kërkesave dhe afateve të vendosuar nga AKPA dhe projekti.
3. Mungesa e bashkëpunimit dhe të kuptuarit nga instruktorët e praktikës dhe stafi tjetër i shkollës.
4. Mendimet e stafit të shkollës se çdo detyrë që lidhet me praktikën profesionale është e planifikuar në orët e parashikuara dhe të paguara për koordinatorët e marrdhënieve me biznesin.

V. 2 Perceptimet e nxënësve mbi praktikën profesionale

Gjerësisht në diskutimet që zhvillohen me nxënësit mbi praktikën profesionale në biznese, ata shfaqen të kënaqur dhe të bindur tashmë se kjo eksperiencë do tu shërbejë më së shumti në të ardhmen dhe profesionin e tyre. Ky konstatim na vihet në dukje jo vetëm nga diskutimet me vetë nxënësit por gjithashtu edhe nga informacioni i shprehur nga mësuesit e tyre të cilët ndjekin hap pas hapi vijueshmërinë e praktikave të nxënësve gjatë vitit. Normalisht që një pjesë e nxënësve, kryesisht në vitet e X dhe të XI, të veshur me naivitetin e moshës dhe padijen që mund t'i karakterizojë në këtë moshë, influencohen ndjeshëm nga mendimet që mësuesit ndajnë me ta sa i përket praktikave profesionale. **Për këtë arsye duhet të theksohet se ndarja e mendimeve dhe sugjerimeve të mësuesve në këtë grupmoshë**

është shumë e rëndësishme edhe sa i përket pritshmërive dhe kënaqësisë që nxënësit shprehin.

Ndryshe nga vitet e mëparshëm, nxënësit e viteve të X janë më të rezervuar sa i përket të shprehurit mbi kënaqësinë dhe eksperiencën e tyre gjatë praktikës profesionale në biznes. Nëse i referohemi diskutimeve me nxënësit e viteve të XI, XII dhe XIII, ata theksojnë se **përgjatë dy viteve të fundit aktivitetet dhe ndërveprimi me bizneset, sa i përket orarit të praktikës, ka qenë më i kufizuar por ndërkohë intensiteti i veprimit në oraret e kufizuara ka qenë më i lartë. Kjo praktikë e filluar në të shumtat e rasteve në këto vitet e fundit është përmbyllur me punësimin e nxënësve me kohë të pjesshme apo edhe me kohë të plotë në këto biznese.** Në këtë mënyrë gjerësisht nxënësit shprehën se praktika e realizuar në biznese është shumë efikase për sa i përket: shansit që të jep për t'u punësuar në biznes; konkretizimit të asaj çfarë marrin fillimisht në teori duke e zbatuar në kushte reale pune e në presion të kohës; i njëjta me mjete të reja, teknika dhe metoda të reja dhe më të avancuara si edhe me lëndë të tjera që nuk i kanë njohur fizikisht më parë. **Ata gjithashtu e përcaktojnë praktikën si hapi i parë konkret drejt tregut të punës.** Praktikimi në atmosferë pune reale shihet si parapërgatitje për tregun e gjerë të punës pas mbarimit të shkollës, por edhe një mundësi për të shfaqur aftësitë në biznesin pritës, me idenë për t'u punësuar prej tij gjatë ose pas përfundimit të praktikës.

Një pjesë e nxënësve angazhohet në biznes edhe jashtë orarit të praktikës, duke përfituar edhe stimuj monetarë e në disa raste, pagesë të plotë mujore. **Në dallim nga viti i kaluar, vihet re një rritje e numrit të nxënësve që marrin shpërblime nga bizneset në të cilat realizojnë praktikën, kryesisht kjo konstatohet në profilin e hoteleri-turizmit dhe profilet industriale.** Por siç është vënë në dukje edhe në studimin sasior pavarësisht se numri i nxënësve që shprehën të kënaqur për shpërblimin që marrin ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, vetëm 50% e tyre shprehën të kënaqur me masën e shpërblimit. Për të kuptuar më mirë se përse pjesa tjetër e nxënësve nuk ka shprehur kënaqësinë sa i përket shpërblimit të marrë ne e kemi konsideruar këtë çështje për diskutime më të hollësishme gjatë studimit cilësor në të cilin u vu re se: Pavarësisht se thuajse të gjithë nxënësit e vlerësojnë faktin e përfitimeve monetare dhe shpërblimeve që u jepet nga biznesi në të cilin zhvillojnë praktikën, ata janë të pakënaqur me nivelet e pagesës dhe vlerësimin e tregut në tërësi për profesionin e tyre. Një pjesë e nxënësve nuk shfaqin kënaqësi për shpërblimet e tyre sepse e krahasojnë masën e përfituar me pagën e punonjësve të përhershëm të biznesit apo edhe e krahasojnë atë me nxënësit e tjerë që kanë përfituar një shpërblim në masë më të madhe në një biznes tjetër. Gjithashtu gjatë diskutimit me nxënësit e profilit Hoteleri-Turizëm, në ndryshim nga vitet e tjera, këtë vit konstatohet se konsumi i vakteve të ushqimit, gjatë kohës së qëndrimit në biznes, konsiderohej i detyrueshëm për bizneset. Në ato pak raste ku nxënësit përcaktonin se në biznesin ku ata zhvillonin praktikën nuk mundësohej konsumi i vaktit ushqimor, vihej re një paragjykim i dukshëm mbi biznesin nga pjesa tjetër e nxënësve në grup.

Sa i përket informimit të nxënësve mbi proceset e praktikës profesionale në biznese rezulton se nxënësit e vitit të XII dhe XIII janë më të informuar ndërsa nxënësit e viteve X dhe XI janë kryesisht të informuar vetëm për proceset bazë si përcaktimi i tyre në biznes, monitorimi nga mësuesit dhe vlerësimi i praktikës. Vihet re një kapërcim i disa prej fazave si përgatitje e CV-së dhe letrës së motivimit, njohje me bizneset, përzgjedhje, intervistimi me sugjerimin dhe përcaktimin e nxënësve në biznes nga mësuesit. Të gjithë nxënësit janë të informuar mbi detyrimin e instruktorëve në shkollë për ndjekjen e nxënësve në biznes, por në pjesën më të madhe të rasteve shprehen se frekuencat e vizitave nga mësuesit janë të ulëta dhe do preferonin të ishin më të shpeshta. Njëkohësisht të gjithë janë në dijeni të caktimit të një instruktori në biznes, por informacioni mbi rolin e tij kufizohet vetëm në asistimin dhe orientimin gjatë praktikës, si dhe në vlerësimin final të nxënësit, ndërkohë që aspekte të tjera si: dhënia e kontributit në hartimin e planeve individuale të praktikës, këshillimi mbi përzgjedhjen e profilit, etj. nuk njihen nga nxënësit. Sa i përket procesit të vlerësimit të gjithë nxënësit janë të informuar se në vlerësimin përfundimtar të praktikës profesionale kontribuon edhe instruktori i biznesit por jo të gjithë e kanë të qartë se në çfarë mase kontribuon ky vlerësim. **Në përgjithësi, informacioni mbetet në nivele bazike, mbështetur kryesisht në proceset/veprimtaritë ku nxënësit marrin vetë pjesë dhe që finalizohen me një produkt konkret.**

Gjatë diskutimeve me nxënësit **evidentohen edhe raste të rralla të eksperiencave jo të kënaqshme në biznesin ku kryenin praktikën profesionale**, në këto raste përgjithësisht zgjidhja është menduar ndryshimi i biznesit. Disa nga shkaqet kryesore që i kanë shtyrë nxënësit të ndrojnë biznes sa mbështetur në perceptimin dhe pritshmërinë e vetë nxënësve apo edhe gatishmërinë e bizneseve për t'i përfshirë praktikantët në proceset e punës apo edhe integruar në marrëdhënie me stafin lidhen kryesisht me:

- a. mbulimin e vazhdueshëm të punëve që i konsiderojnë të rëndomta (pastrim ambientit, larje enësh, qërim patatesh, sistemim dosjesh apo magazine etj.);
- b. distanca dhe oraret në biznes (në disa raste oraret e përcaktuara nga biznesi janë të tejzgjatura apo gjithashtu pamundësia e transportit për të arritur në biznes).
- c. mungesa e shpërblimeve apo edhe e vlerësimit jo monetar të shprehur, i ndryshëm për nxënësit në biznese të ndryshme.
- d. mungesa e të gjithë sektorëve në biznes (në disa raste nxënësit pasi pozicionohen në biznes shohin se mungon ai sektor në të cilin ata kanë pretenduar të zhvillohen më tepër profesionalisht).
- e. raportet jo të mira me instruktorin në biznes apo anëtarë të tjerë të stafit (rrallëherë shfaqet një mospërshtatje e nxënësit me frymen e krijuar mes stafit dhe instruktorit apo ndonjëherë edhe një raport jo fort i mirë mes nxënësit dhe ndonjë punonjësi në biznes).

V.2.1 Perceptimi i nxënësve për instruktorët e praktikave dhe instruktorët e bizneseve

Gjatë procesit të praktikave profesionale nxënësit shohin si aktorë drejtues instruktorët e praktikave profesionale, ku në disa raste zëvendësohet nga koordinatori i marrdhënieve me biznesin si edhe aktorin e dytë, instruktorin/mentorin në biznes i cili përfshihet në proces nga momenti i prezantimit të tyre në biznes.

Përsa u përket instruktorëve në shkollë dhe përgatitjes së tyre për të organizuar dhe menaxhuar punën për praktikën, përgjatë diskutimeve nxënësit shprehen se ata këtë vit kanë qenë të detyruar të veprojnë me ritme më të shpejta për të mirëorganizuar fazën parapërgatitore që i sistemon nxënësit në biznese (në këto kushte një pjesë e madhe e shkollave nuk ka ndjekur aplikimin nëpërmjet ndërtimit të CV-ve dhe letrës së motivimit, por e kanë ndërtuar atë vetëm si punë projekti për të qenë të informuar mbi procedurën dhe këto dokumentacione. Vetëm në disa raste të veçanta është zhvilluar përzgjedhja e bizneseve nga nxënësit, më pas intervistat dhe në vijim caktimi i secilit nxënës në biznes). Në drejtim të monitorimit, **jo të pakët janë nxënësit që shprehen se instruktorët në shkollë duhet të rrisin vizitat në biznese për të qenë më të pranishëm dhe të mos konsiderojnë vetëm komunikimin nëpërmjet telefonatave apo edhe fotot për qëllime të reklamimit të procesit të praktikës** (ky konstatim është jo plotësisht i përputhshëm me rezultatet që vijnë nga studimi sasior ku 74% e nxënësve janë shprehur të kënaqur me procesin e monitorimit). Së fundi, si proces përmbyllës **sa i përket vlerësimit** nxënësit shprehen se janë në dijeni të vlerësimit të dyfishtë që i bëhet nga instruktorët në biznese dhe nga instruktorët e praktikave në shkollë dhe shprehen të kënaqur, në raste të rralla nxënësit kërkojnë që pesha e vlerësimit të instruktorit në biznes të jetë në të njëjtën masë siç është sugjeruar pavarësisht se instruktorët e praktikave mund të mos kenë njohje personale me instruktorët e bizneseve.

Një element tjetër që nxënësit vlerësojnë nga instruktorët e praktikës në shkollë apo edhe nga mësuesit e tjerë, është se gjatë zhvillimeve të lëndëve teorike ata përpiqen ta konkretizojnë mësimin me shembuj duke bërë të mundur në këtë mënyrë edhe përputhshmërinë e koncepteve dhe njohurive të marra nga ana teorike në shkollë me ato njohuri të fituara në praktikë në biznes.

Vlen të theksohet se kërkesa për shkëputje të marrëdhënieve të një nxënësi me biznesin trajtohet me kujdes nga koordinatori i MB dhe instruktorët në shkollë, ata fillimisht tentojnë të kuptojnë ku qëndron problemi dhe si mund të adresohet një zgjidhje për palët edhe pse në këtë vit rastet më të shpeshta janë zgjidhur me kthimin e nxënësve në ambientet e shkollës apo në zhvillimin e praktikës në një biznes të ri pasi instruktorët në shkollë nuk kanë preferuar të rëndojnë me diskutime të tepërta situatat me bizneset.

Sipas mendimeve më të shpeshta të shprehura nga nxënësit, sa i përket instruktorëve në biznese, vihet re se mentorët e atyre bizneseve që kanë një kohë më të gjatë bashkpunimi me shkollën kanë përgatitje të kënaqshme profesionale dhe kanë ç'tu mësojnë praktikantëve duke e zhvilluar këtë proces tashmë në mënyrën më normale dhe të natyrshme. Kjo situatë evidentohet edhe në studimin sasior të kryer, ku kënaqësia e nxënësve, sa i përket vëmëndjes së treguar nga mentori apo stafi në biznes është rritur me 18 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017. Ndërsa sa u përket instruktorëve të pozicionuar në bizneset më me emër të zonës edhe pse janë ndër më të aftët nuk preferohen nga të gjithë nxënësit pasi sipas tyre ngarkesa që këta instruktorë kanë në punët e tyre bën që ata të fokusohen vetëm në ata nxënës që shfaqin përkushtim më të madh dhe aftësi në profesion që në orët e para të praktikës. Gjithsesi në përgjithësi nga nxënësit që kanë përvojë më të gjatë në praktikën nga viti në vit, biznesi dhe instruktori në biznes rezulton më i përgatitur. Gjithashtu ata shprehen se bizneset më të reja kanë instruktorë që janë më të hapur dhe më mikpritës ndaj praktikantëve në vendin e punës.

V.2.2 Nxënësit që kanë zhvilluar praktikën në ambientet e shkollës

Në këtë vit, një numër më i madh nxënësish se në vitin e kaluar kanë ndjekur praktikën profesionale pranë ambienteve të shkollës. Pavarsisht tendencës së shkollave të reja për të implementuar skemën e praktikës profesionale afatgjatë pranë bizneseve, si edhe vijueshmërinë e ndjekjes së kësaj praktike nga shkollat e përfshira në bashkëpunimin me projektin prej vitesh, ndikimi i pandemisë dhe kufizimet që e shoqëruan sistemin arsimor kanë sjellë një reduktim të numrit të nxënësve që zhvillojnë praktikën pranë bizneseve. **Nxënësit të cilët kanë zhvilluar praktikën pranë laboratorëve kanë mendime të larmishme mbi zhvillimin e moduleve të praktikës profesionale, por vlen të theksohet se pjesa më e madhe e tyre (rreth 70% e tyre) shprehin dëshirën dhe predispozitën e lartë për të qenë pjesë e skemës së praktikës profesionale që zhvillohet pranë bizneseve.** Më së shumti dëshirën për të qenë pjesë e praktikës profesionale pranë biznesit e lidhin me arsyetimin se pranë një biznesi ata mund të shohin konkretisht mjete dhe teknika pune të reja që i njohin ata me kushtet reale të punës dhe kjo i mundëson më pas edhe përthithjen e lehtë në tregun e punës. Një pjesë e këtyre nxënësve shprehen se vetëm të qenurit pranë përditshmërisë së biznesit të mundëson përditësimin dhe azhornimin e njohurive në lidhje me profesionin ndryshe nga çfarë mund të ndodh në ambientet e shkollës ku vijojnë të ngelen vetëm në njohjen e disa mjeteve baze dhe teknikave tashmë të vjetëruara në profesion.

Ndërsa nxënësit të cilët shprehën dëshirë për të vijuar praktikën profesionale pranë laboratorëve të shkollës, të pakët në numër, përkrahnin këtë ide për disa arsye që ata parashtruan, si më poshtë shënuar:

1. *Sugjeruar si alternativë më e mirë nga intrukturët e praktikave.* Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale në ambientet e shkollave, instruktorët e praktikave që në orët e para të prezantimit të tyre, parashtrojnë disa arsye pse zhvillimi i praktikave

profesionale në shkollë është më i sugjerueshëm prej tyre. Të pa informuar mbi detajet e tjera një pjesë e nxënësve vijnë arsyetimin e tyre vetëm në bazë të këtyre shpjegimeve të parashtruara prej instruktorëve. (kryesisht nxënësit e klasave të X të profilit Hoteleri-Turizëm në shkollën Salih Ceka, Hamdi Bushati; profili tekstil konfeksion në shkollën Hamdi Bushati; nxënës të drejtimit ekonomik në shkolla të ndryshme; nxënësit e vitit të X dhe XI të profileve industriale në shkollat Ali Myftiu dhe Pavarësia si edhe disa nxënës nga shkolla Gjergj Canco).

2. *Të qenurit më të sigurt në ambientet e shkollës.* (kjo arsye është shumë më e zbehtë krahasuar me 2-3 vjet më parë dhe vijon të shfaqet në ata nxënës që kanë një natyrë më introverte, të mbyllur. Duke qenë se ambientet e biznesit për ta janë të panjohur dhe më dinamike ata preferojnë të jenë në ambientet e shkollës të cilat konsiderohen më të sigurt për ta).
3. *Mungesa e dëshirës për tu përfshirë në aktivitete që lidhen me profesionin.* (Kjo arsye shprehet nga ata nxënës që shfaqnin edhe performancë të ulët përgjatë studimeve të tyre. Ata kërkonin të ishin pasiv edhe në këtë proces duke menduar se qëndrimi në shkollë i mundëson atyre edhe mospërfshirjen fizike por vetëm qëndrimin në rolin e vëzhguesit).
4. *Të qenurit jo komod në ambientet e biznesit.* Në raste shumë të rralla nxënës të cilët janë përcaktuar për të zhvilluar praktikën profesionale në një biznes mund të jenë ndjerë jo komod për mënyrën sesi e trajtojnë, për mënyrën sesi stafi i biznesit komunikon me njëri tjetrin apo edhe për faktin që nuk është pozicionuar në pozicionin që nxënësi preferon. Në këto nxënës që kanë ngritur të tilla shqetësime në ndonjë rast të rrallë, nxënësit ka vendosur të kthehet në shkollë dhe të vijojë praktikën profesionale në ambientet e shkollës.
5. *Mungesa e besimit për të gjetur një biznes të përshtatshëm për profilin e tyre.* Kryesisht kjo arsye vihet re në dy drejtime, atë të ekonomikut dhe atë të Tik-ut, ku nxënësit mendojnë se për tu pozicionuar në kompanitë që ofrojnë shërbime të profilit të tyre është e nevojshme marrja e informacioneve në nivele shkollimi më të larta. Ata mendojnë se njohuritë që kanë përthithur nuk janë të mjaftueshme për tu pozicionuar në ato kompani që ata preferojnë dhe në këtë mënyrë ata gjykojnë se për momentin shkolla është mundësia më e mirë për zhvillimin e praktikës, deri në një moment të dytë ku ata do të mund të pranohen dhe konsiderohen nga këto kompani.

V.3 Fotografim i thjeshtëzuar i shkollave mbi zbatimin e skemës së sugjeruar të praktikave profesionale

Sa mbështetur në diskutimet dhe percetimet e mësuesve dhe nxënësve mbi gjithë procesin e praktikave profesionale në vitin akademik, më poshte është paraqitur në mënyrë tabelore për cdo shkollë përmbledhtazi disa fakte të konstatuara. Gjithashtu, fillimisht në tabelë janë përcaktuar profilet të cilat zhvillohen në secilën shkollë.

	Kolin Gjoka	Hamdi Bushati	Kristo Isak	Pavarësia	Tregtare	Gjergj Canco	SHTET	Ali Myftiu	Salih Ceka
Profilet									
Hoteleri-Turizem	X	X	X		X				X
T . I . K	X			X		X			X
Sherbime sociale dhe Shendetesore	X		X						
Ekonomi - Biznes	X	X	X		X		X		X
Teknologji Ushqimore	X								
Tekstil-Konfeksione		X					X		X
Elektronike						X			
Mekanike				X				X	
Elektroteknike				X		X		X	
Sherbime Mjetesh Transporti				X				X	
Instalues I Sistemeve Termohidraulike				X					X
Ndertim								X	

<p>Konstatime gjatë diskutimeve</p>	<p>Sfidë shpërndarja në biznese e profilit të teknologjisë ushqimore.</p> <p>Mungese e laboratorëve që shfaq mangësi më tej edhe në plotësimin me detaje të skemës së sugjeruar mbi praktikat.</p>	<p>Profili hotelierit turizem në vitet e X këtë vit ndjekin praktikën profesionale në shkollë.</p> <p>Shkëputja e drejtoreshës së shkollës ka impaktuar në prishjen e harmonisë dhe bashkëpunimit brenda grupit të mësuesve.</p>	<p>Ne kete vit disa nga nxënësit kane qene ne lëvizje në biznese të ndryshme</p> <p>Përshtatje e profilit të shërbimit social me situatën aktuale dhe nxënësit të përmbushur</p>	<p>E nevojshme seleksionimi i bizneseve egzistuese</p> <p>Një pjesë e bizneseve nuk regjistran nxënësin në tatime dhe as nuk krijojnë kushtet e nevojshme të sigurisë.</p>	<p>Të punësuar në biznese mbi 90% e nxënësve të profilit hotelierit turizëm.</p> <p>Përfshirja e bizneseve në fushaten prezantuese të shkollës.</p>	<p>Instrukturët e praktikës kanë një mënyrë individuale të perceptuarit të skemës së sugjeruar.</p> <p>Nxënësve e profilit TIK, ndjehen të shfrytëzuar gjatë praktikës kur ngarkohen me punë reale pa shpërblime.</p>	<p>Këtë vit shfaqen marrëdhënie të qëndrueshme shkollë-biznes për praktikat profesionale.</p> <p>Nxënësit shfaqin interes të lartë për të qenë pjesë e praktikës në biznes</p>	<p>Nxënësit e profilit të ndërtimit shprehin nevojën për një kurikul më të përshtatshme me nevojat e tregut aktual.</p> <p>Sipas nxënësve polica e sigurimit paguhet nga ta në mënyrë individuale.</p>	<p>Praktika për nxënësit e viteve të X kryesisht zhvillohen në shkollë.</p> <p>Marrdhëniet shkollë-biznes janë ngritur dhe vijnë të zhvillohen kryesisht në bazë të njohjeve personale nga ana e mësuesve.</p>
-------------------------------------	--	--	--	--	---	---	--	--	--

	<p>Nxenesit jo plotesisht te qarte mbi procesin e vlersimit të praktikës profesionale</p> <p>Transporti i siguruar nga shkolla, por shqetesim orari.</p>	<p>Monitorimi i nxënësve në biznes është zhvilluar shume i cunguar gjatë vitit.</p> <p>E nevojshme per mbarevajtjen e praktikave në biznes delegimi i detyrave nga drejtuesi i shkolles.</p>	<p>Pezullimi i praktikës profesionale në kohën e pandemisë.</p>	<p>Klasat që zhvillojnë praktikën në shkollë dhe biznese sjell vështirësi në meaxhimin e procesit dhe monitorimin e tyre.</p>	<p>Mentorët e bizneseve me famë fokusohen në nxënësin më të mirë dhe nxënësit e tjerë i lenë në hije.</p> <p>Mungesa e përfshirjes në pozicione të përshtatshme të nxënësve në biznes për profilin ekonomik.</p>	<p>Nevoja për mësues të motivuar në ndjekjen e procesit të praktikave profesionale në biznese.</p> <p>Mësuesit me moshë më të re shfaqin predispozita më të larta për të bashkpunuar me bizneset.</p>	<p>Mësuesit në tërësi shprehen entuziast për praktikatat në biznes.</p>	<p>Artikulohet nevoja për ndërtimin e strategjisë afatgjatë për shkollat profesionale si edhe plotësimi i laboratorëve me mjete të përditësuar.</p> <p>Shqetësim monitorimi i nxënësve në distanca të largëta kryesisht për nxënësit e rretheve.</p>	<p>Profili tekstil-konfesion ka një kërkesë në rënie, pavarisht se shkolla siguron lidhje të mirë me biznesin dhe i mundëson punësim nxënësve.</p> <p>Profili i hidros referuar natyrës së tij vijon marrveshje me ustallarë (pavarisht se janë të pa deklaruar).</p>
--	--	--	---	---	--	---	---	--	---

VI. Konstatimet e studimit cilësor në vijim të rezultateve të studimit sasior

Gjatë studimit cilësor u konsideruan edhe një sërë çështjesh që ishin trajtuar fillimisht në studimin sasior dhe kryesisht informacioni që u konstatua gjatë diskutimeve me nxënësit dhe mësuesit e shkollave vijonte në të njëjtën linjë si edhe rezultatet e marra nga studimi sasior. Kështu disa çështje dhe konstatime që rezultuan në të dy studimet janë:

1. **Numri i nxënësve që e kanë përzgjedhur shkollën, si variantin e tyre të parë, krahasuar me vitet e mëparshme, ka ardhur duke u rritur.** Edhe pse kryesisht përzgjedhja e shkollës ka qënë si opsion i parë konstatohet gjatë diskutimeve se rreth 17% e rasteve nuk janë regjistruar në profilin që ata kanë preferuar. Në vijim të shprehjes së preferencës së tyre për shkollën nxënësit gjatë diskutimeve shprehen të kënaqur me kushtet që shkollat ofrojnë si edhe me stafin përbërës pedagogjik të shkollave.
2. **Në pjesën më të madhe të rasteve si burimi i informimit mbi egzistencën e shkollës dhe profilet që ato ofrojnë kanë qënë shokët dhe shoqet.** Një burim tjetër shumë i rëndësishëm që ka mundësuar informacion mbi shkollën për nxënësit e shkollave 9-vjecare kanë qënë vizitat e shkollës apo eventit i “dyerve të hapura” ku shkollat profesionale ftojnë në ambientet e tyre nxënës dhe shkolla 9-vjecare. Gjithashtu rrjetet sociale vijojnë të luajnë një rol të rëndësishëm për informimin e nxënësve potencial por gjithashtu edhe për nxënësit e vetë shkollës, të cilët informohen mbi aktivitetet që profilet e tjera të shkollës zhvillojnë në ambientet e shkollës së tyre.
3. **Një ndër arsyt kryesore që nxënësit shprehin se janë mbështetur për të bërë zgjedhjen e profilit dhe shkollës është mundësia që profesioni të ofron për tu punësuar.** Këtë vit kjo arsye artikullohet qartësisht nga nxënësit gjatë diskutimeve me ta.
4. **Mungesa e informacionit mbi aktivitetet që shkollat organizojnë si edhe mungesa e informacionit mbi egzistencën dhe funksionet e qëndrës së karrierës është e lartë në nxënësit e klasave të X.** Ndryshe nga vitet e kaluara nxënësit e klasave të X, si pasojë e orareve të kufizuara dhe mungesës së aktiviteteve të larmishme të kushtëzuara në këtë mënyrë nga pandemia COVID-19, nuk kanë pasur mundësi të njohin dhe vizitojnë qendrën e karrierës.
5. Nëse në vitet e kaluara shfaqej një tendencë që të shtohet numri i profileve dhe nxënësve brënda të njëjtit profil që zhvillonin praktikën profesionale pranë biznesit, në këtë vit kjo tendencë është zbehur. Në një situatë paksa të tkurrur nga ndikimi i pandemisë përpjekjet për të zhvilluar një praktikë pranë bizneseve ka rënë si nga ana e instruktorëve të praktikës ashtu edhe nga nxënësit. **Në këtë vit është konstatuar një rritje e numrit të nxënësve që zhvillojnë praktikën pranë laboratorëve në shkolla.**
6. Në grupimin e nxënësve që zhvillojnë praktikën pranë bizneseve vihet re se pjesa më e madhe e tyre shprehen të kënaqur me gjetjen e vendit të praktikës nga shkolla. Kështu **në 10 nxënës që zhvillojnë praktikën profesionale pranë bizneseve, 8 prej tyre shprehen të kënaqur me biznesin e përzgjedhur.**

-
7. Vlen të theksohet se pavarisht kushteve të krijuara nga pandemia një fenomen që vihet re më tepër këtë vit është **rritja e numrit të nxënësve që marrin shpërblim nga bizneset** në të cilat ata zhvillojnë praktikën profesionale. Gjithashtu ndonëse jo në të gjitha rastet, vlerësimi që kanë bizneset për nxënësit shprehet në mënyrë monetare, gjatë diskutimit nxënësit shprehen se bizneset mundohet ta shprehin edhe në mënyra të tjera vlerësimin që kanë për ta.
 8. **Disa nga nxënësit reflektojnë pakënaqësi nga shpërblimi/paga që mundësohet nga bizneset.** Në ndryshim nga vitet e tjera ku niveli i nxënësve që përfitonin shpërblime apo edhe një pagesë, nga biznesi në të cilin kryejnë praktikën, ka qenë i ulët, në këtë vit diskutohet mbi masën e kësaj pagesave, pasi numri i nxënësve që përfitojnë shpërblime dhe pagesa ka ardhur duke u rritur. Arsye kryesore pse nxënësit reflektojnë pakënaqësi është sepse ata e krahasojnë shpërblimin e tyre me punonjësit egzistues të bizneseve apo edhe e krahasojnë sasinë e shpërblimit apo pagës me nxënësit të tjerë që mund të përfitojnë më shumë në biznese të ngjashme.
 9. **Numri i nxënësve të shkollave profesionale që kanë si synim vazhdimin e shkollës së lartë është në nivele të ulëta.** Kështu, dy nga dhjetë nxënësit të intervistuar shfaqin një dëshirë për të vijuar me shkollën e lartë pas përfundimit të shkollimit profesional. Kryesisht nxënësit e profileve ekonomik, TIK-ut dhe Sherbimeve sociale janë ata që shprehin një interes më të lartë për vazhdimin e shkollës së lartë.

Disa çështje të tjera që u theksuan më tepër në studimin cilësor se në rezultatet e studimit sasior janë si më poshtë:

1. **Në diskutimet me disa nga profilet** si tekstil-konfeksione, TIK-u dhe në profilin e ndërtimit, **nxënësit kanë theksuar më tepër se në studimin sasior, mospërshtatjen e drejtimit me tregun e punës.** Kështu pjesa më e madhe e nxënësve të tekstil konfeksionit përcaktojnë se ndryshe nga ajo që tregu kërkon (p.sh stilistë apo edhe prerje e qepje të modeleve të përdorura së fundmi), në shkollë vijojnë të përdoren metodologji dhe modele të vjetëruara për profilin. E njëjta gjë përcaktohet edhe nga profili i ndërtimit, nxënësit shprehen se nëse profili i tyre më tepër në treg është duke u zhvilluar në ndërtimin e gipseve, apo ndërtimeve me mjete të reja ata në shkollë vijojnë të mësojnë vetëm ndërtimin e një muri të thjeshtë me llac e tulla. Gjithashtu sa i përket profilin të TIK-ut nxënësit shpjegojnë se në ambientet e shkollës dhe nga mësuesit e tyre nuk disponohen mjetet, programet dhe njohuritë më të sofistikuara të profilin e kjo kryesisht vihet në dukje nga ata nxënësit të cilët kanë pasur mundësi të kenë eksperiencë me biznese aktive në treg.
2. Vëmëndja e mentorëve të biznesit sipas nxënësve, vijon të ngelet në të njëjtat nivele përkushtimi ndaj tyre si edhe një vit më parë. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, ku përpjekja ishte më e madhe që bashkpunimi nxënës-biznes të rritej, këtë vit pjesa më e madhe e mësuesve e kanë evituar tendencën për të ndërhyrë në përmirsimin e kësaj marrdhënieje duke e spostuar nxënësin në një biznes tjetër.

-
3. Në dhjetë nxënës, shtatë prej tyre shprehin dëshirën për tu punësuar jashtë atdheut, pasi në gjykimin e tyre kjo do ti mundësonte paga shumë më të mira dhe jetesë më të mirë. Për të parin vit gjatë diskutimit, një pjesë e vogël e nxënësve shprehin propozimin se projekti mund t'iu mundësoi një lidhje me biznese të huaja për tu punësuar jashtë Shqipërisë. Eksperienca që mund të fitojnë në biznese të huaja do ti shtonte vlerë në zhvillimin profesional përtej faktik se do ti ofronte paga dhe nivel jetese më të mirë.

VII. Përfitimet e konsideruara nga mësuesit dhe nxënësit në lidhje me praktikat profesionale

Gjatë diskutimet të zhvilluara me nxënësit dhe mësuesit e shkollave u evidentuan dhe renditën një sërë përfitimesh që rrjedhin nga realizimi i praktikave profesionale në biznese. Një pjesë e këtyre përfitimeve shihen të shtrira në kohë e një pjesë i referohen një momenti specifik, gjithashtu ato mund ti referohen vetëm një individ apo edhe më gjerë. Padiskutim që jo të gjithë aktorët e marrë në shqyrtim arritën të artikulojnë të gjitha përfitimet e përcaktuara më poshtë por kryesisht jemi mbështetur për renditjen e tyre në kontributin që dhanë aktorët më aktiv në diskutim

Disa nga përfitimet e nxënësve që u artikulua gjatë diskutimit me ta janë:

- ✓ **Përballja e hershme me tregun e punës dhe njohja e tij** – të qënurit pranë një biznesi, përtej faktit të aftësive, e pajis nxënësin me njohuri të plota mbi mënyrën sesi tregu i punës funksionon. Në këto rrethana, nxënësi përballlet me punëdhënësin mbi mënyrën sesi realizohet komunikimi punëdhënës-punëmarrës; mbi kërkesat që punëdhënësit kanë; iu krijohet një mundësi kontakti dhe njohjeje me aktorët aktiv në profesionin e tyre etj...
- ✓ **Njohja e mjeteve, instrumentave, programeve dhe teknikave që përdoren në kushte reale pune** – Normalisht bizneset edhe për arsyen bazike të tyre, përfitimit, përpiqen të implementojnë në ambientet e tyre teknikat më të mira dhe marrin instrumentat që i përshtaten më mirë. Pajisja me elementët më të fundit i mundëson nxënësve të shohin nga afër dhe të kuptojnë mënyrën sesi ato përdoren në përmbushje të profesionit të tyre.
- ✓ **Punësimi i nxënësve me kohë të pjesshme dhe të plotë gjatë viteve të shkollës** – Në ndryshim nga nxënësit e shkollave të mesme të përgjithëshme instrumenti si kontrata tri-palëshe u ka mundësuar të drejtën nxënësve që të qëndrojnë pranë ambienteve të biznesit dhe pse jo të punësohen me një pagë. Kjo marrëveshje i ka krijuar kushte favorizuese nxënësve për të qenë më të kërkuar në tregun e punës nga bizneset.
- ✓ **Përfitimi i një shpërblimi monetar** – shpeshherë nxënësit gjatë periudhës së praktikës së tyre, përtej vlerësimit jomonetar të shprehur nga bizneset kanë përfituar edhe një përfitim monetar sado të vogël.
- ✓ **Përmirsimi i aftësive të buta dhe elementëve bazë të profesionit** – Duke u vendosur në mjedise reale pune, ata mund të përpiqen të menaxhojnë kohën dhe situata të vështira që mundo të përballen, të përmirsojnë komunikimin, të njihen me disa rregulla pune dhe etikën e punës, të mund të bashkëpunojnë në grup për

detyra të caktuara apo edhe të zgjidhin problema që mundo të lindin në përditshmërinë e punës.

- ✓ **Konkretizimi i njohurive teorike të marra në shkollë** – Pavarësisht sesa nxënësit e kanë të zhvilluar imagjinatën, në studimet mbi metodologjinë e të mësuarit, është konfirmuar se mënyra më e mirë e të mësuarit është nëpërmjet alternimit të trajtimeve teorike me anën vizuale. me atë teorike nëse është e mundur. Kështu duke

Përfitimet të shkollës dhe instruktorëve të praktikave profesionale që u artikulojnë janë:

- ✓ **Përmirësimi i imazhit të shkollave dhe promovimi i tyre** – në sajë të pozicionimit të nxënësve në biznese të larmishme, bizneset e njohin dhe e konsiderojnë shkollën për potencialin e punonjësve të tyre të ardhshëm si edhe për profesionistët që ajo formon për tregun e punës. Në të njëjtën kohë prindërit e nxënësve që zhvillojnë praktikën pranë bizneseve kanë kuptuar seriozitetin e këtij procesi dhe shohin nga afër zhvillimin dhe arritjet profesionale të fëmijëve të tyre. Konsideruar raste suksesi të nxënësve që janë aftësuar gjatë procesit të praktikës edhe komuniteti e vlerëson dhe e sheh shkollën si një vlerë e shtuar për të rinjtë e rajonit.
- ✓ **Punësimi i nxënësve në biznese nëpërmjet ndërmjetësimit të shkollës** – rritja e numrit të nxënësve të punësuar karritur besimin e komunitetit në shkollën profesionale. Kështu tashmë prindërit besojnë më tepër në shkollën profesionale se fëmijët e tyre do të aftësohen dhe do kenë më të lehtë punësimin nëse kryejnë studimet në këto shkolla. Nga ana tjetër vetë bizneset duket se po i besojnë më tepër potencialeve apo sugjerimeve të shkollës për stafin e tyre dhe kjo tregohet edhe me rritjen e kërkesës së bizneseve për të punësuar nxënës të shkollave.
- ✓ **Pozicionimi i shkollave më pranë tregut të punës** – në kushtet e kontakteve të herëpashershme, shkollat dhe vetë mësuesit po mund të kenë një informacion më të përditësuar mbi kërkesat dhe nevojat që tregu ka, veçanërisht kërkesat që kanë bizneset me të cilat po bashkëpunojnë. Ky proces ndihmon në fokusimin e nevojave të tregut duke influencuar ndryshimet apo edhe përditësimet në kurikula.
- ✓ **Nxitje e instruktorëve në shkolla për rritjen e tyre profesionale** – Pavarësisht shkollimit dhe eksperiencave të mëparshme të instruktorëve, të qënurit pjesë e procesit të praktikave profesionale i ka mundësuar atyre përditësimin me teknikat e reja, eksperiencat e veçanta të bizneseve dhe normalisht tendencave më të fundit të tregut. Siç edhe vetë instruktorët shprehin në diskutime, kjo eksperiencë për ta ka ndikuar në rritjen profesionale që vjen jo vetëm në sajë të trajnimeve

specifike por edhe të komunikimit të vazhdueshëm me nxënësit të cilin i sjellin detaje të përditshmërisë së praktikës që realizojnë në biznesin përkatës.

- ✓ **Ndryshimi i opinionit mbi vlerën e arsimit të mesëm profesional në tërësi –** Aktorët por kryesisht mësuesit me disa vite eksperiencë në shkollat profesionale pranojnë se, në vitet e mëparshme ndjeshëm filloi të ndjehej që në burimet e tyre, opinionin e publikut se në shkollat profesionale regjistrohen nxënësit që kanë rezultate më të dobëta. Aktualisht, falë mundësisë që u krijohet nxënësve për një aftësim simbiotik teori-praktikë dhe falë rritjes së shanseve për t'u bërë pjesë e tregut të punës në profilin përkatës, ky opinion vit pas viti po ndryshon. Edhe gjatë diskutimeve me nxënësit vërehet se mes tyre ka element shumë të mirë të cilët kanë qënë nxënës me rezultate të shkëlqyera gjatë studimeve në 9-vjeçare dhe me bindje të plotë janë regjistruar në këto shkolla për të qënë një profesionist shumë i zoti në atë drejtim që ata kanë përzgjedhur.

VIII. Sfidat e këtij procesi që evidentohen nga aktorët

Në një mjedis dinamik, ku influenca e faktorëve të jashtëm është jo plotësisht e parashikueshme dhe njëkohësisht ndryshimet e natyrshme që ndodhin vit pas viti brënda institucioneve bashkëpunuese, sjellin sfida të reja me të cilat aktorët e përfshirë në praktikën profesionale duhet të përballen. Disa nga sfidat që shfaqen në vijim të diskutimeve me drejtuesit, mësuesit e shkollave profesionale dhe nxënësit janë si më poshtë:

- *Përshtatja e kurikulave dhe profileve të shkollave profesionale me kërkesat dhe nevojat e tregut.* Pavarisht tendencave që disa nga mësuesit mund të kenë për të realizuar modulet dhe kurikulat sipas metodologjive e nëpërmjet mjeteve më të fundit të fushës përkatëse, ata në trajtimin e kurikulave duhet ti përshtaten moduleve që tashmë janë miratuar. Duke konsideruar diskutimet me nxënësit e disa profileve lind nevoja e azhurnimit dhe përditësimit të tyre në mënyrë që profili të jetë sa më i përshtatur me kërkesat aktuale të tregut.
- *Nevoja për përcaktimin e qartë në nivel kombëtar, të strategjive afatgjata për shkollat profesionale.* Është e nevojshme që vetë shkollat të ndërtojnë plane dhe objektiva afatgjatë në përmbushje të strategjisë kombëtare mbi arsimin profesional. Gjithashtu në vijim të këtyre strategjive kombëtare do të mundësohej përcaktimi i rregulave të reja për potencialet pranuese dhe njëkohësisht mund të lehtësohet koordinimi dhe bashkëpunimi me shkollat 9-vjeçare.
- *Zbatimi i specifikave të vendosura në rregulloren e re të dërguar nga AKPA.* Në këtë rregullore janë përcaktuar disa specifika që vështirësojnë veprimtarinë në realitet të procesit të praktikave profesionale në biznese sipas skemës së sugjeruar nga projekti. Ndryshe nga çfarë është sugjeruar në këtë rregullore, jo çdo biznes me të cilin shkollat bashkëpunojnë është i regjistruar në dhomën e tregtisë. Gjithashtu përcaktimi i % së orëve që duhet të realizohet në biznes nga nxënësit komplikon organizimin e procesit të praktikave nga instruktorët e praktikës profesionale.
- *Plotësimi paraprak me materiale të nevojshme i profileve të reja.* Në disa raste propozimi dhe hapja e profileve të reja nuk është shoqëruar edhe me materiale të paracaktuara mbi këto profile. Pavarisht tendencës së shkollave për të hapur profile që i përshtaten nevojave të parashtruara nga bizneset, është e nevojshme që baza materiale të plotësohet përpara se profili të filloj regjistrimet e nxënësve. Në këtë mënyrë, mund të shmanget mungesa e materialeve të nevojshme mbi profilet e reja.
- *Angazhimi i instruktorëve në monitorimin/ndjekjen e njëkohësishme të nxënësve që realizojnë praktikën në biznes dhe atyre që i zhvillojnë në shkollë.* Në disa raste ku klasat janë me më pak se 24 nxënës, s'mund të ketë më tepër se 1 instruktor praktike për zhvillimin e praktikës së tyre. Në këto kushte, detyrimit për të qenë pranë nxënësve që kryejnë praktika në shkollë i mbivendoset atij të monitorimit nga afër të nxënësve në biznese duke krijuar një situatë të vështirë për t'u menaxhuar. Në disa raste, kur bizneset janë të vendosura larg njëri tjetrit dhe janë në numra të lartë, kjo situatë bëhet edhe më komplekse për tu menaxhuar.

-
- *Shpërndarja e nxënësve në biznese me distanca të largëta gjeografike si edhe monitorimi i tyre nga instruktori.* Monitorimi nga afër i çdo nxënësi të pozicionuar në biznes bëhet e vështirë dhe një sfidë më vete në kushtet e bizneseve të lokalizuara në hapsira të largëta gjeografike. Ky proces bëhet edhe më i vështirë për tu menaxhuar kur për mbikqyrjen e nxënësve është një instruktor i vetëm.
 - *Mbulimi i njëkohësishëm nga ana e instruktorëve në biznes, i punëve për të cilat janë përgjegjës në biznes, si edhe instruktimin e nxënësve praktikantë.* Tashmë është e njohur se në biznese roli i mentorëve realizohet nga individë të cilat kanë paraprakisht punë të mirëpërcaktuar lidhur me një pozicion në biznes. Në këto kushte, mentorët duhet të përmbushin detyrimet e pozicionit në biznes, dhe në një hapsirë të mundëshme të instruojnë edhe nxënësit praktikantë.
 - *Ndërgjegjësimi i bizneseve mbi rolin që luajnë në zinxhirin e shkollimit profesional.* Jo çdo biznes e ka të qartë rolin dhe ndikimin që ka në këtë proces, në këtë rrjedhë jo çdo mentor e konsideron si një përgjegjësi të vetën zhvillimin dhe rritjen profesionale të nxënësve. Një mënyrë e mirë që mund të shërbejë si një hap për të rritur ndërgjegjësimin e mentorëve mund të konsiderohet përfshirja e tyre në takime dhe tryeza të rrumbullakëta.
 - *Egzistenca e bizneseve të specializuara apo të fokusuara.* Përgjithësisht bizneset e sotme prirjen të jenë tepër të specializuara në proceset dhe produktet që ato zhvillojnë. Në këtë mënyrë përcaktimi i nxënësve për të zhvilluar praktikën profesionale pranë tyre, i heq mundësinë atyre për të zhvilluar të gjitha modulet që janë të përcaktuara në kurikulum. Shmangia e kësaj sfide mund të jetë nëpërmjet rotacionit të nxënësve në biznese të ndryshme.
 - *Praktikat e punësimit të nxënësve nga biznset.* Duke qenë se është një proces i cili po vijon të bëhet shumë i shpeshtë, brënda kornizës së shkollës është e nevojshme ti kushtohet një vëmendje e veçantë, që në vijimësi të jetë një proces sa më i suksesshëm dhe i besueshëm. Për rritjen e cilësisë së këtij procesi sugjerohet ndërtimi i një strukture të posaçme brenda ambienteve të shkollave.
 - *Përballja me perceptimin/gjykimin e bizneseve dhe komunitetit në lidhje me cilësinë e nxënësve të shkollave profesionale.* Në diskutime të shumta vihet re dhe shprehet se, për vite kontigjenti që përfshihej në këto shkolla ishte në nivelet më të ulëta të performimit. Në këtë frymë nxënësit shprehen se edhe në kohët aktuale, në klimën e krijuar nga rastet e pakënaqësive që mund të lindin në biznes nga nxënës me nivel jo të mirë performance, reflektohet edhe në marrdhënien që biznesi ka me nxënësit e tjerë dhe me vetë shkollën. Në këto rrethana nevojitet që bizneset të ndërgjegjësohen mbi faktin se jo të gjithë nxënësit janë njëllor, ata duhen diferencuar dhe i duhet dhënë mundësi sipas kapacitetit dhe dëshirës që ata tregojnë.
 - *Realizimi i orientimit dhe këshillimit në karrierë në mënyrë të detajuar për nxënësin.* Pavarësisht ndërtimit të strukturave përgjegjëse pranë shkollave sa i përket procesit të këshillimit dhe orientimit në karrierë, vihet re nga diskutimet me nxënësit se një pjesë e madhe e tyre janë të pa informuar plotësisht sa i përket profilit dhe drejtimit të tyre.

Në këto kushte sugjerohet që këto struktura përkatëse të jenë më proaktive me nxënësit.

- *Rritja e numrit të nxënësve praktikantë në drejtime që kanë kufizime nga ofertat e tregut.* Sa konsideruar bizneset lokale, vihet re se për disa drejtime, si në rastin e profilit të inxhinierisë ushqimore në shkollën “Kolin Gjoka”, kemi një numër të kufizuar biznesesh dhe ndërkohë rritja e numrit të nxënësve që regjistrohen për të ndjekur këto profile, e bën edhe më të vështirë procesin e shpërndarjes së nxënësve nëpër biznese për zhvillimin e praktikës. Do të ishte e përshtatshme që në këto raste, në bazë të një inputi nga bizneset për këto drejtime të kërkuara, të zhvillohen profile të ndryshme si edhe të mendohen kufizimet në numër të tyre mbështetur në kapacitetin e shkollës dhe kërkesën e tregut të punës.
- *Plani i nxënësve për tu larguar jashtë vendit.* Vijon të jetë një ndër sfidat e përvitshme për këto shkolla. Kjo sfidë reflektohet si në bashkëpunimin që ka shkolla me bizneset ashtu edhe në perceptimin që krijohet në komunitet. Në bashkëpunimin me bizneset kjo evidentohet në stepjen e tyre për të marrë dhe aftësuar këta nxënës që në fund të ciklit sërish do të largohen. Ndërsa sa i përket perceptimit të komunitetit, në këtë situatë krijohet ideja se marrja e një profesioni në këto shkolla shërben si mundësi e mirë për tu larguar edhe më lehtë nga vendi e për tu sistemuar në tregun e huaj. Kjo sfidë tashmë është kthyer më përgjithësuese në rang vendi, kështu që mund të themi se nevojiten politika të mira kombëtare që rrisin nivelin e kënaqësisë së popullsisë dhe zgjojnë shpresën për një të ardhme më të mirë në vijimësi.

IX. Adresimet përkatëse, mbështetur në diskutime mbi sfidat e konstatuara

Në mbështetje të të gjithë diskutimeve, sugjerimeve nga aktorët e marrë në konsideratë, të dhënave të konstatuara në studimin sasior dhe raportet e mëparshme të së njëjtës natyre studimi po rendisim si më poshtë disa adresime në vijim të sfidave të parashtuara.

- *Ndërtimi i strategjive afatgjata kombëtare për shkollimin profesional.* Me ndërtimin e këtyre strategjive panorama e së ardhmes së shkollave profesionale do të jetë edhe më e qartë. Kjo do të mundësojë shkollave profesionale kushte konkurruese të barabarta me shkollave të tjera të mesme të përgjithëshme.
- *Rishikimi i disa çështjeve të trajtuara në rregulloren e re të AKPA-s.* Në pamundësi për t'iu përshtatur rregullave të përcaktuara në këtë rregullore të publikuar shihet e nevojshme përshtatja e tyre duke konsideruar mjedisin real në të cilin shkollat profesionale operojnë.
- *Shpërndarja e skemës së praktikës profesionale afatgjatë në biznes nëpërmjet drejtuesve të shkollave, në instruktorët e praktikave profesionale.* Kjo do të mundësonte njohjen nga instruktorët e praktikave në shkollë të çdo procesi të praktikës profesionale që sugjerohet nga projekti që të ndiqet. Kjo do të shërbente së tepërmi instruktorëve të praktikave të përfshirë së fundmi në këtë pozicion në shkollat profesionale dhe gjithashtu do të shërbej si një informacion rifreskues edhe për instruktorët e praktikës që e ndjekin këtë proces prej disa vitesh
- *Ndërgjegjësimi i instruktorëve të praktikave profesionale, për rolin e rëndësishëm që ata luajnë në procesin e praktikave profesionale edhe kur ato zhvillohen në biznese.* Kjo do të mundësonte suportin e nevojshëm të instruktorëve të praktikës për mirëfunksionimin e praktikave profesionale pranë bizneseve. Roli që ata kanë në perceptimin dhe orientimin e mendimeve të nxënësve është i pazëvendësueshëm në këtë proces.
- *Gjetja e mekanizmave favorizuese për bizneset që shprehin interes për të bashkëpunuar në procesin e praktikës profesionale.* Në këtë mënyrë një pjesë e mirë e bizneseve që janë të orientuar të masin përfitimet e tyre afatshkurtra do të jenë më të përfshirë dhe të fokusuar në mirëfunksionimin e gjithë procesit të praktikave profesionale.
- *Ndërtimi i materialeve bazike për profilet e reja përpara se drejtimi të fillojë regjistrimet me nxënës.* Duke i plotësuar këto profile me materiale paraprake nuk do të kemi mangësi dhe orë fiktive mësimore që nga viti i parë që profili i ri do të implementohet në një shkollë profesionale.
- *Këshillimi dhe orientimi i nxënësve në karrierë që në fazat e para të përzgjedhjeve të tyre.* Ky proces ka vlerë nëse ai ndodh përpara momentit kyç të bërjes së një zgjedhjeje nga ana e nxënësit. Në këtë mënyrë mund të adresohet problematika e informimit dhe ndërgjegjësimit të nxënësve mbi profilin/drejtimin dhe njëkohësisht i pajis ata me informacion se çfarë tregu i punës i ofron.

-
- *Seleksionimi i kujdesshëm i bizneseve partnere nga shkollat.* Tashmë është e nevojshme që shkollat të përcaktojnë disa kushte minimale që bizneset duhet të plotësojnë dhe ti qëndrojnë plotësisht procesit të seleksionimit të këtyre bizneseve me të cilat do të bashkëpunojnë. Në këtë proces selektiv sugjerohet që shkollat të shmangin njohjet personale dhe të jenë sa më objektive.
 - *Organizimi i tryezave të diskutimit ndërmjet bizneseve.* Këto tryeza diskutimi shërbejnë që bizneset të ndajnë sëbashku eksperiencat e tyre mbi procesin e praktikave profesionale por njëkohësisht shërbejnë si një motivim për bizneset duke e konsideruar veten edhe më të përfshirë në skemën e bashkëpunimit në sajë të vlersimit që i jepet atyre duke i bërë pjesë e aktiviteteve të përbashkëta.
 - *Shkollat duhet të konsolidojnë procesin e punësimit të nxënësve nga bizneset.* Duke konsideruar shpeshësinë e hasur të këtij procesi në shkolla, është e nevojshme që të konsiderohet si një proces i vazhdueshëm dhe të krijohen struktura të posaçme për ndjekjen e tij. Nëse ky proces bëhet më i dedikuar dhe rafinohet nga ana profesionale, do të mundësojë një përshtatje të mirë ndërmjet nxënësve dhe biznesit dhe do të jetë më i besueshëm për kërkesa e punësimit në të ardhmen.
 - *Përshtatja e drejtimt me tregun e punës nëpërmjet azhornimit të mjeteve, materialeve dhe metodologjive që zhvillohen në lëndën e praktikave profesionale.* Në disa raste nxënësit i gjejnë njohuritë e përfituara në shkollë, në drejtimin e tyre, larg kërkesës që tregu parashtron. Për këtë arsye është e nevojshme që kryesisht lëndët profesionale, apo specifikisht modulet e praktikës, të azhurnohen me kërkesat e tregut aktual dhe të implementojnë mjetet, teknologjitë dhe metodat më të fundit të profesionit.

ANEKS

Tabela 2: Aktorët e përfshirë në studim sipas shkollave

	Shkollat								
	Kolin Gjoka	Hamdi Bushati	Kristo Isak	Pavarësia	Tregtare	Gjergj Canco	SHTET	Ali Myftiu	Salih Ceka
Metoda dhe aktorët									
Intervista të thelluara Drejtues/Mësues	2	3	1	2	4	3	2	3	4
Nxënës në total	19	22	7	10	20	18	6	25	20
<i>Fokus grupe</i>	17	22	0	0	15	18	0	25	20
<i>Intervista të thelluara</i>	2		7	10	5	0	6	0	0
Total i aktorëve për shkollë	21	25	8	12	24	21	8	28	24

Tabela 3: Zbatimi i skemës së propozuar

Proceset e praktikës profesionale	Shkollat								
	Kolin Gjoka	Hamdi Bushati	Kristo Isak	Pavarësia	Tregtare	Gjergj Canco	SHTET	Ali Myftiu	Salih Ceka
Procesi i paraorientimit në karrierë	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata
Orientimi në karrierë gjatë regjistrimeve	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.	Përpjekje për tu realizuar në kufizimet e situatës.
Krijimi i rrjetit të bizneseve partnere, zgjerimi dhe mirëmbajtja	Përditësime të vogla.	Kryesisht janë mbajtur të njëjtat lidhje dhe shtuar bizneset e reja që janë paraqitur në shkollë.	Përditësime të vogla.	Përditësime të vogla.	Janë konsideruar bizneset e reja për vendosjen e marrëdhënieve.	Rritur numri nëpërmjet mbështetjes së projektit S4J	Rritur numri nëpërmjet mbështetjes së projektit S4J	Përditësime të vogla.	Përditësime të vogla.
Përdorimi i marrëveshjes së praktikës profesionale	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.	Në të gjitha rastet.
Aplikimi i nxënësve në biznese/ Ndërtimi i CV-	Realizuar ndërtimi por jo në të gjitha rastet janë	Zhvilluar si aktivitet por nuk ka qenë thelbësor për përzgjedhjen	Realizuar si detyrë projekti dhe në raste të rralla për	Realizuar ndërtimi por jo në të gjitha rastet janë përdorur në	Realizuar ndërtimi por jo në të gjitha rastet janë përdorur në	Në rastet e nxënësve që kanë bërë aplikime në biznese është zhvilluar për	Në rastet e nxënësve që kanë bërë aplikime në biznese është	Në disa klasa relaizuar si detyrë projekti.	Realizuar si detyrë projekti dhe në raste të rralla për

ve dhe letrave të motivimit	përdorur në procesin e përzgjedhjes.	e nxënësve nga bizneset.	aplikim në biznese.	procesin përzgjedhës.	procesin përzgjedhës.	aplikim, pjesa tjetër e nxënësve e kanë konsideruar si një detyrë projekti.	zhvilluar për aplikim, pjesa tjetër e nxënësve e kanë konsideruar si një detyrë projekti.		aplikim në biznese.
Planifikimi i praktikave	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale dhe vënë në dijeni biznesin.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale dhe vënë në dijeni biznesin	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.	Vetëm nga instruktorët e praktikës profesionale.
Rotacioni	Në pozicione të së njëjtit biznes. Vetëm profili inxhinierisë ushqimore realizon rotacion në biznese pasi bizneset kanë poste të kufizuara.	Në pozicione të së njëjtit biznes.	Në disa raste të profilit hotelier-turizëm shfaqet rotacioni në biznese të ndryshme.	Në raste të rralla realizohet në pozicione të së njëjtit biznes.	Në pozicione të së njëjtit biznes.	Në drejtimin TIK nuk realizohet. Në drejtimin elektroteknik shfaqet rotacion nxënësish në të njëjtin biznes (ndrohen nxënësit)	Realizuar në pozicione të së njëjtës zyrë.	Në raste të rralla haset duke u realizuar në pozicione të së njëjtit biznes.	Në pjesën më të madhe të rasteve zhvillohet në pozicione të së njëjtit biznes.
Monitorimi	Në varësi të instruktorit të praktikës	Shumë i zbehtë.	Në profilin e shërbimit social	Kryesisht nëpërmjet	Kryesisht nëpërmjet komunikimit	Nga koordinatori i marrëdhënieve me biznesin dhe	Ka pak raste, që ndjekin praktikën në	Kryesisht nëpërmjet komunikimit	Kryesisht nëpërmjet komunikimit

	por kryesisht ka qenë më intensive se vitin e kaluar.		instruktori i praktikës shoqëron nxënësit. Në rastin e profilit hotelierit turizëm, kryesisht nëpërmjet komunikimit telefonik.	komunikimit telefonik.	telefonik por e alternuar me vizita në biznese.	në raste të rralla instruktorët e praktikave në kontakt me biznesin.	biznes dhe instruktorët e praktikës profesionale janë munduar të mos i mbingarkojnë bizneset me kontakte të shpeshta.	telefonik për bizneset e shtrira larg qytetit, ndërsa bizneset e vendosura pranë qytetit alternohen me vizita.	telefonik dhe vizitave për profilin hotelierit turizëm, TIK dhe hidraulik. Profili i konfeksionit shoqërohet nga instruktor të praktikës.
Mentorimi	Ka vijuar në të njëjtën mënyrë si një vit më parë.	Ka vijuar në të njëjtën mënyrë si një vit më parë..	Në profilin hotelierit turizëm është ndjerë një frymë demotivuese e influencuar nga situatë në biznese.	Në raste të rralla shfaqen neglizhenca nga instruktorët në biznes, duke adresuar më së shumti përgjegjësitë që i ngarkohen nga pozicioni i punës.	Mentorët edhe më të përfshirë në procesin e aftësimin të nxënësve (kryesisht për profilin hotelierit turizëm)	Ka vijuar në të njëjtën mënyrë si një vit më parë.	Për herë të parë evidentohet nga nxënësit në këtë shkollë dhe ata janë të kënaqur me kohën që ju dedikohet nga mentori.	Në disa raste vihet re një marrëdhënie miqësore dhe familjare e mentorëve me nxënësit.	Bizneset në disa raste kanë qenë edhe më të përfshirë në procesin e mentorimit kur nuk kanë pasur ngarkesa të tjera.
Vlerësimi	Edhe pse për mësuesit është shumë i qartë, nxënësit jo të gjithë e	Janë të qartë për vlerësimin dhe shprehen se në atë format është	Në disa raste rezulton se nxënësit e njohin ndikimin e biznesit në vlerësim dhe	Janë të qartë për vlerësimin dhe shprehen se në atë format është ndjekur procesi.	Janë të qartë për vlerësimin dhe shprehen se në atë format është ndjekur procesi.	Kryesisht vlerësimi realizohet nga mësuesi duke konsideruar edhe performancën që ka realizuar	Mësuesit marrin në konsideratë mendimin e biznesit por rastet e praktikave të	Në disa raste është shfaqur nga nxënësit pakënaqësi në moskonsiderimin e plotë të	Janë të qartë për vlerësimin dhe shprehen se në atë format

	kanë të qartë masën e kontributit në vlerësim të biznesit.	ndjekur procesi.	në disa raste ata mendojnë që mësuesi është ai që vlerëson duke marrë në konsideratë edhe vijueshmërinë në biznes.			nxënësi pranë biznesit.	vlerësimet në këtë formë janë të pakëta sepse janë një numër i vogël nxënësish që zhvillojnë praktikën pranë bizneseve dhe kryesisht ata janë nxënësit me performancë më të mirë.	vlerësimet të biznesit.	është ndjekur procesi.
Këshillimi mbi karrierën	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata	I kufizuar nga situata